Raport
Gjendja e Mjedisit
2015



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

AMMK

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH





MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT TË KOSOVËS

Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2015 Raport

Prishtinë, 2015

Procedura e miratimit të Raportit

Me datën 25 Qershor 20015, Drejtoria për Gjendjen e Mjedis ka përfunduar Raportin dhe e ka dorëzuar në Zyrën e kryeshefit të AMMK-së, dhe ka kërkuar procedimin e tij për miratim në Kuvendin e Kosovës sikurse e parasheh neni 25 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Me datën 2 Korrik 2015, kryeshefi i AMMK-së, përmes Ministrit të MMPH-së, i ka drejtuar Qeverisë së Kosovës, propozimin për rend dite: Procedimi në Kuvendin e Kosovës i Raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2015.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29 gusht 2015 ka shqyrtuar si pikë të rendit të ditës Raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015, dhe ka marrë vendimin nr.01/86, përmes të cilit ka miratuar Raportin dhe ka kërkuar që i njëjti të procedohet në Kuvendin e Kosovës.

Me datën 29 shtator 2015, në mbledhjen e 22 të tij Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor, ka shqyrtuar Raportin për gjendjen e mjedisit për vitin 2015, dhe e ka proceduar atë në Kuvendin e Kosovës.

Në seancën plenare të datën 30 Nëntor 2015, pas shqyrtimit të Raportit, Kuvendi i Kosovës ka marrë Vendimin nr. 05-V-183, për miratimin e Raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/86
Datë: 28.08.2015


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me 28 gusht 2015, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet Raporti për gjendjen e Mjedisit në Kosovë për vitin 2015.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA
Kryeministri i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministravet)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015, pas shqyrtimit të Raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015, miori këtë:

VENDIM

1. Miratohet Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

Nr. 05-V-183
Prishtinë, më 30 nëntor 2015

Kryetari i Kuvendit,
Kadri VESELI

Vendimi iu dërgohet:
- Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Komisionit për Bujqësi, Pyllitari, Mjedis e Planifikim Hapësinor.
- Arkivit të Kuvendit.

Parathënie



Të nderuar lexues,

Mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore vazhdon të mbetet një nga sfidat më të mëdha të shoqërisë sonë.

Nevojat për zhvillim ekonomik dhe kërkesat sociale në rritje, kanë shtuar edhe kërkesat për shfrytëzim të resurseve natyrore por edhe ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis përmes shkarkimit të ndotësve.

Prodhimi i energjisë, zhvillimi i transportit, industria prodhuese, zhvillimet në sektorin e bujqësisë janë disa nga presionet direkte në mjedisin tonë, që vazhdojnë të jenë në rritje.

Përkundër kësaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor vazhdon të mbetet e përkushtuar që në frymën e zhvillimit të qëndrueshëm të zbatojë kërkesat për *mbrojtjen e mjedisit. Hartimi i legjislacionit mjedisor dhe zbatimi i tij, hartimi i strategjive, planeve dhe programeve mjedisore janë vetëm disa nga angazhimet tona të* përditshme në *kuadër të arritjes së objektivave për mbrojtjen e mjedisit.*

Fuqizimi i sistemit për monitorimin e gjendjes së mjedisit, rritja e kontrollit në zbatimin e legjislacionit mjedisor si dhe aplikimi i procedurave dhe standardeve mjedisore përballë kërkesave për *shfrytëzim të resurseve natyrore dhe zbatim të projekteve që vlerësohet të kenë ndikim në mjedis paraqesin sfida por edhe po japin rezultate të kënaqshme.*

Investimet në mjedis të realizuara qoftë nëpërmjet buxhetit të Kosovës apo edhe përmes ndihmës së donatorëve me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe përmirësimit të infrastrukturës mjedisore por edhe ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale mjedisore në të gjitha nivelet, na bëjnë të besojmë që jemi në rrugën e duhur që të *realizojmë qëllimet tona.*

Rezultate të pamohueshme janë arritur në të gjitha segmentet mjedisore si në menaxhimin e mbeturinave, në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, në menaxhimin e ujërave, në adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, me zbutjen e pasojave të tyre, në rehabilitimin e zonave të ndotura, në kontrollin e ndotjes industriale, në planifikimin hapësinor si dhe në bashkëpunimin regjional dhe ndërkombëtarë.

Ne besojmë fuqishëm që përmes bashkëpunimit me qytetarë, institucionet qeveritare, komunat, donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile do të përmbushim synimin që Kosova të jetë një vend i zhvilluar me mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Ferid Agani, *Ministër i MMPH-së*

Falënderim



Të nderuar lexues dhe bashkëpunëtorë,

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka kënaqësinë të ndajë me ju Raportin, Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2015. Raporti është përgatitur në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore që ka AMMK për raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit. Raporti përmban kryesisht të dhëna nga monitorimi i gjendjes së mjedisi por edhe të dhëna nga projekte, publikimi dhe dokumente tjera relevante për mjedisin.

Pjesë e raporti janë edhe të dhënat nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë përgjegjësi të caktuara në sektorin e mjedisit dhe që ofrojnë të dhëna nga ky sektor. Përgatitja e raportit është mbështetur edhe nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Me këtë rast në emër të AKMM, shpreh falënderim dhe mirënjohje të gjithë atyre që kontribuuan në finalizimin e këtij dokumenti, qoftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ne i vlerësojmë, çmojmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve, OJQ-ve mjedisore dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Shpresojmë që ky raport do të jetë një kontribut modest, jo vetëm për informimin real për gjendjen e mjedisit në Kosovës por edhe një dokument që do ti shërbejë politikbërësve në zbatimin e politikave të qëndrueshme mjedisore dhe donatorëve në orientimin e projekteve të ardhshme.

***Dr.sc. Ilir Morina,** Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së*

Shkurtesat

ADC	Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim
ALPS	Hulumtimi i Ndotjes së Tokave Bujqësore
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
AMRK	Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Nukleare
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
APN	Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimit Vendor
CLC	Mbulueshmëria e Tokave sipas Metodologjisë CORINE
DL	Dekreti Ligjor
DU	Departamenti i Ujërave
ECRAN	Rrjeti Rregjional i Paraaderimit për Mjedis dhe Klimë
EEA	Agjencioni Evropian i Mjedisit
EFAS	Rrjeti Evropian i Vetëdijesimit nga Vërshimet
EIONET	Rrjeti Evropian Mjedisor për Informim dhe Vëzhgim
EPA Net.	Rrjeti Evropian i Kryeshefave të Agjencive të Mjedisit te vendeve të Evropës
EUROSTAT	Statistikat e Evropës
GHG	Gazrat e Serrës
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publikë të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës
JICA	Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFW	Banka Gjermane për Zhvillim
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KTOE	Kilo Ton Oil Equivalent
KUR	Kompania e Ujësjellësve Rajonal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural

MEF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MN	Monument i Natyrës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatorë Ekonomik
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PIK	Korniza e Politikave për Industrinë e Kosovës
PK	Park Kombëtar
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
REC	Qendra Regjionale për Mjedis
RM	Rezervat Natyrorë
SIDA	Agjencia Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SNK	Strategjia për Ndryshime Klimatike
SOER	Raporti i Gjendjes së Mjedisit të Evropës
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC	Konventa Kornizë për Ndryshimin Klimatike e Kombeve të Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZRRUK	Zyra Rregullatorë për Ujësjellës dhe Kanalizim

Përmbajtja

1. **Pjesa hyrëse**
   - 1.1. Hyrje
   - 1.2. Metodologjia
   - 1.3. Qëllimi i raportit
   - 1.4. Të dhëna të përgjithshme për Kosovën
   - 1.5. Përmbledhje e përgjithshme e raportit
2. **Forcat Shtytëse**
   - 2.1. Trendi demografik
   - 2.2. Urbanizimi dhe mjedisi
   - 2.3. Zhvillimi socio-ekonomik
   - 2.4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore
   - 2.5. Përdorimi tokës dhe mbulushmëria e saj
3. **Presionet** në **mjedis**
   - 3.1. Energjia
   - 3.2. Industria
   - 3.3. Transporti
   - 3.4. Bujqësia
   - 3.5. Pylltaria
   - 3.6. Turizmi
4. **Gjendja e mjedisit**
   - 4.1. Ajri
   - 4.2. Uji
   - 4.3. Dheu/toka
   - 4.4. Mbeturinat
   - 4.5. Biodiversiteti
   - 4.6. Zonat e Mbrojtura
5. **Ndikimet në mjedis dhe shëndet publik**
   - 5.1. Ndryshimet klimatike
   - 5.2. Ndikimi në shëndetin publik
6. **Reagimet/Masat e ndërmarra**
   - 6.1. Legjislacioni
   - 6.2. Strategjitë dhe planet mjedisore
   - 6.3. Sistemi i monitorimit të mjedisit
   - 6.4. Investimet në mjedis
   - 6.5. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar
7. **Referencat**
8. **Indeksi i figurave dhe tabelave**

1. Pjesa hyrëse

1.1. Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1]. Sipas nenit 25 të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit, Raport për Gjendjen e Mjedisit.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: Gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, zbatimin e Strategjisë së Mjedisit, Planit të Veprimit, masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin e resurseve natyrore, zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është institucioni që harton këtë dokument.

1.2. Metodologjia

Bazuar në modelet e pranueshme të raportimit dhe në rrethanat ekzistuese mjedisore në Kosovë, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Për t'i përmbushur kërkesat e raportit, të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport. Këto të dhëna janë në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.

Raporti ofron të dhëna për forcat shtytëse dhe presionet në mjedis, përshkruan gjendjen aktuale të mediumeve mjedisore dhe ndikimin e kësaj gjendjeje. Trajton në një masë politikat e ndjekura për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit si dhe angazhimin e institucioneve qeveritare, joqeveritare dhe të shoqërisë në përgjithësi për përmirësimin e gjendjes. Një formë e tillë e raportimit që njihet si Modeli DPSIR[2], dhe i cili paraqet shqetësime për të gjitha problemet mjedisore në vend dhe është një mënyrë shumë e përshtatshme për vlerësimin e gjendjes së mjedisit.

Modeli DPSIR fillimisht është përdorur nga OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim), pastaj është adoptuar nga Agjencia Evropiane për Mjedisin (EEA), e që përdoret gjithashtu edhe nga EUROSTAT për prodhimin e statistikave mjedisore. Ky model analitik mundëson organizimin e informacionit dhe integrimin e elementeve socio-ekonomike dhe mjedisore, duke adresuar marrëdhëniet ndërmjet pesë kategorive të treguesve: Forcat shtytëse (siç janë: fuqia prodhuese, rritja e popullsisë etj.), Presionet në mjedis (si: emisionet në ujë, ajër dhe tokë), të cilat ndikojnë në gjendjen e mjedisit (p.sh., përqendrimin e metaleve të rënda në tokë, ngritjen e temperaturave mesatare globale), të cilat më pastaj ndikojnë në qenie të gjalla dhe në shëndetin e njeriut duke imponuar kështu përgjigje ose reagim të institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura (masa legjislative, taksa, programe mjedisore, hulumtime, investime etj). (Figura 1).

1 Ligji Nr. 03/L-025, për Mbrojtjen e Mjedisit

2 D-Driving Forces. P-Pressures, S-State of the Environment , I-Impacts, R-Responses *(D-Forcat shtytëse, P-Presionet, S-Gjendja e mjedisit, I-Ndikimet dhe R-Reagimi)*




Figura 1: Korniza analitike DPSIR

Në masë të konsiderueshme hartimi i këtij raporti është orientuar edhe nga përzgjedhja e indikatorëve (treguesve) të cilët kanë qenë më të përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Jemi përpjekur që indikatorët e zgjedhur të kenë bazë shkencore dhe të jenë të kapshëm nga të gjithë ata që do të shërbehen me këtë raport. Natyrisht që në përzgjedhjen dhe prezantimin e treguesve mjedisorë sipas kapitujve dhe nënkapitujve të raportit ka ndikuar deri diku edhe kualiteti i të dhënave në dispozicion dhe periudha kohore që përfshijnë këto të dhëna.

Mungesa e të dhënave për shumë çështje të rëndësishme dhe mungesa e monitorimit të integruar të mjedisit, janë disa prej problemeve me të cilat AMMK është përballur gjatë hartimit të tij.

Duhet pranuar faktin se cilësia e raportimit varet nga cilësia e monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Meqenëse këto dy sisteme mjedisore tek ne janë ende në fazën e ngritjes dhe forcimit, për disa nga sektorët që trajtohen në këtë raport ka pasur mungesë të dhënave të plota dhe të besueshme.

1.3. Qëllimi i raportit

Qëllimi kryesore i këtij raporti është përmbushja e obligimit ligjor për Raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit tek institucionet qendrore të vendit (Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës), si dhe ofrimi i informatave relevante dhe reale në bazë të së cilave do të nxitej hartimi i politikave adekuate mjedisore.

Raporti ofron një bazë të mirë edhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: industria, energjetika, transporti, bujqësia etj., por edhe për ndërmarrja e masave të duhura dhe hartimin e projekteve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe përbërësve të tij.

Jo më pak i rëndësishëm është qëllimi për informimin për gjendjen e mjedisit në Kosovë, të publikut të gjerë, donatorëve, studiuesve dhe grupeve tjera të interesit.

1.4. Të dhëna të përgjithshme për Republikën e Kosovës

Sipërfaqja e territorit	10.908 km^2
Numri total i popullsisë	1.84 milion banorë (2013)
Dendësia e popullsisë për km^2	167 (2013)
Mosha mesatare	Rreth 25 vjeç
Mosha mesatare e jetëgjatësisë	76.7 vjet
Shpallja e pavarësisë	17 shkurt 2008
Sistemi Politik	Demokraci Parlamentare
Statusi në procesin e integrimeve në BE	Vend kandidat potencial
Gjuhët zyrtare	Shqipe, Serbe
Kryeqyteti	Prishtina
Numri i komunave	38
Numri i vendbanimeve	1469
Monedha	Euro
BVP për kokë banori	2.721 Euro
Paga mesatare mujore	170 Euro
Klima	E mesme kontinentale
Temperatura mesatare vjetore	11 ^{0} Celsius
Reshjet mesatare vjetore	790 mm
Lumenjtë më të mëdhenj	Drini i Bardhë (111.5 km), Sitnica (110 km)
Maja më e lartë	Gjeravica, 2.656 m
Pika më e ulët	Lugina e Drinit të Bardhë (kufiri me Shqipëri), 297 m

1.5. Përmbledhje e përgjithshme e Raportit

Raporti Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2015, përmban 6 kapituj. Në **pjesën hyrëse** të raportit përveç parathënies është prezantuar edhe metodologjia e përdorur për hartimin e raportit, qëllimi i raportit dhe një përmbledhje tabelare e të dhënave të përgjithshme për Kosovën.

Në pjesë e dytë të raportit përkatësisht në pjesën e **forcave shtytëse në mjedis** janë trajtuar disa nga forcat që vlerësohet se janë shtytësit kryesorë mjedisorë. Është vlerësuar se **trendi i rritjes së popullsisë** në Kosovë vazhdon të jetë progresiv sikurse edhe shtimi natyror përkundër faktit që krahasuar me vitet 80 dhe 90 ka shënuar rënie. Dendësia e popullsisë në Kosovë është ndër më të mëdhatë në Evropë, ndërkohë që Kosova është ndër vendet me sipërfaqe me të vogla banimi. Raporti vlerëson që ka pasur trend te rritjes së **zonave urbane** sikurse që ka pasur edhe trend të rritjes së popullsisë urbane.

Edhe pse Kosova në dhjetëvjeçarin e fundit vazhdon të ketë **rritje ekonomike** pozitive, ajo ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Evropë. Papunësia në vend është 30%, ndërkohë që të ardhurat për kokë banori janë 2.935 Euro. Si rezultat i nevojave për zhvillim ekonomik ka kërkesa në rritje për **shfrytëzimin e resurseve natyrore**. Shpenzimi më i madhe i ujit vjen nga sektori i furnizimit me ujë të pijes dhe nga sektori i bujqësisë, ndërsa që vazhdon të jetë i lartë shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe nga seperacioni minerar. Sa i përket shfrytëzimit të masës drunore, vlerësimet flasin se prerjet legale dhe ilegale vjetore (1.6 milion m^3) e tejkalojnë kapacitetin e prodhimtarisë vjetore te pyjeve. Pyjet dhe tokat pyjore përfaqësojnë kategorinë kryesore të **shfrytëzimit të tokave** me rreth 47%, tokat bujqësore me rreth 29%, livadhet dhe kullosat me 15%, vendbanimet me rreth 4.5%.

Në pjesën e tretë të raportit, trajtohen **presionet** që i bëhen mjedisit nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë sikurse janë: Energjetika, Industria, Transporti, Bujqësia, Pylltaria dhe Turizmi. Secili nga këto sektorë shkakton presione në mjedis përmes formave të caktuara që në raport janë prezantuar përmes indikatorëve të ndryshëm. Raporti konstaton se thëngjilli me 65 % ka pjesëmarrjen, më të lartë në kuadër të burimeve primare **energjetike** në dispozicion, ndërkohë që burimet e ripërtritshme të energjisë përkundër rritjes ende mbesin në nivel të ulët. Krahasuar me vitet e mëhershme konstatohet një rënie e emisioneve të pluhurit, NOx, SO_2 nga KEK, sikurse që vërehet edhe një përmirësim i cilësisë së ajrit në zonën e veprimit të këtij operatori.

Industria e prodhimit të metaleve (NewCoFeronikeli) dhe ajo e prodhimit të çimentos (SharrCem) konsiderohet si industritë më ndikim më të madh mjedisor, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktiviteteve të tyre. Rritja e numrit të automjeteve në **transport** dhe rrugët e reja konsiderohet si presionet kryesore nga sektori i transportit ndërsa që përdorimi i fertilizerëve konsiderohet si një nga presionet kryesore nga **bujqësia** sikurse edhe shfrytëzimi i masës drunore në sektorin e **pylltarisë** dhe rritja e numrit të turistëve në sektorin e **turizmit**. Të gjithë këta tregues shënojnë rritje progresive që do të thotë se edhe rritja e presioneve në mjedis është e njëjtë.

Në pjesën e katërt të raportit trajtohet **gjendja e mediumeve mjedisore** dhe aspekte tematike të këtyre mediumeve sikurse janë: Ajri, Uji, Toka (dheu), Biodiversiteti, Zonat e Mbrojtura dhe Mbeturinat. Për ajrit janë prezantuar të dhëna **për cilësinë e ajrit** nga monitorimin e cilësisë së ajrit, ku konstatohet se tejkalimet e vlerave limite janë regjistruar për Grimcat e PM10 dhe PM2.5, në disa nga stacionet e monitorimit, për gjithë periudhën e monitorimit 2012-2014.

Në **sektorin e ujërave** janë prezantuar të dhëna për cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe sasinë e ujërave të lumenjve. Cilësia e ujërave është prezantuar përmes tre indikatorëve kryesorë: Azotin e joneve Nitrate ($N\text{-}NO_3$), Fosforin nga jonet Fosfate ($P\text{-}PO_4$) dhe Oksigjenin Biokimik të Shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), për periudhën kohore 2008-204. Nga analiza e të dhënave konstatohet se përkundër se ka trend të rritjes së vlerave të treguesve, nuk është konstatuar ndotje e lartë dhe se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar nga eutrofikimi.

Në kuadër të të dhënave për tokën, në raport janë prezantuar të dhëna nga projekti për studimin e tokës bujqësore në Kosovë ku janë analizuar: 2840 mostra toke për 17 metale të renda dhe për treguesit e pjellorisë, 200 mostra për përmbajtjen e ndotësve organik dhe 150 mostra bime për metale t**ë r**ënda. Nga rezultatet është konstatuar se mostrat e analizuara kanë qenë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se rastet e identifikuara me ndotje me metale të rënda nuk janë në zonat që përdoren si toka bujqësore, por në zonat industriale. Në sektorin e mbeturinave është konstatuar se vazhdon të ketë rritje të sasisë së gjeneruar dhe të deponuar të mbetjeve. Në kuadër të prezantimit të gjendjes me menaxhimin e **mbeturinave** ka të dhëna për gjenerimin e mbeturinave industriale dhe medicinale.

Gjendja e biodiversitetit është prezantuar përmes të dhënave për gjendjen e llojeve bimore dhe shtazore kurse ajo e **zonave të mbrojtura** përmes të dhënave për numrin e zonave të mbrojtura të natyrës dhe rritjen e sipërfaqeve të tyre. Raporti konstaton se në kuadër të përpjekjeve për ruajtjen e biodiversitetit dhe vlerësimin e gjendjes së llojeve, Kosova ka hartuar Librin e Kuq të Florës Vaskulare. Ky vlerësim i pari i këtij lloji në Kosovë ka nxjerrë në përfundim se në territorin e Kosovës në kuadër të llojeve të florës vaskulare: 61 lloje janë kategorizuar në shkallën të rrezikuara në mënyrë kritike (CR) , 86 lloje në kategorinë të rrezikuara (EN), 19 lloje në kategorinë të përkeqësuar (VU), 34 lloje në kategorinë gati të rrezikuara (NT) dhe 35 lloje në kategorinë më pak të rrezikuara (LC).

Është konstatuar po ashtu se me shpalljen e Parkut të Dytë Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (62.488.00 ha) dhe me zgjerimin e sipërfaqes së mbrojtur të Parkut Kombëtar "Sharri", është rritur sipërfaqja e mbrojtur nga 4.4 % në 10.9 % të territorit të Kosovës. Është rritur edhe numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura dhe aktualisht janë 116 zona të mbrojtura të natyrës, në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës, 2 Parqe Kombëtare, 99 Monumente të Natyrës, 1 Park Regjional i Natyrës, 2 Peizazhe të Mbrojtura dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.

Në kapitullin e ndikimeve në mjedisit pjesa e pestë e këtij raporti janë trajtuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës. Raporti konstaton se sa i përket emisioneve të gazrave serrë në vitin 2012 emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë ishin 9.5 Mt (milion ton) CO_2 equivalent (9526.74 ton). Sektori i Energjisë është kontribuuesi më i madhe i emisioneve të gazrave të serrës me pjesëmarrje totale prej 87%.

Në kuadër të sektorit të Energjisë, industria energjetike është dominante me 75% te emisioneve, kurse transporti rrugore kontribuon me 12% nga totali i emisioneve nga sektori i energjisë. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës përfaqëson 8% të totalit të emisioneve të gazrave serrë, sektori i mbeturinave me 4% kurse ai i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve është sektori më kontributin më të vogël me vetëm 1% të emisioneve totale.

Krahasuar me vendet tjera në Evropë, Kosova ka emetime më të ulëta për kokë banori (5.4 t CO_2 ekuivalent për kokë banori në vitin më 2012). Ndikimi në shëndetin publik, është prezantuar përmes disa treguesve sikurse janë sëmundjet që vijnë si pasojë e cilësisë e ujërave të pijes, por edhe përmirësimi i infrastrukturës sanitare. Raporti konstaton se ka ende numër të madhe të sëmundjeve diarrike përkundër trendit në rritje të mbulushmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Është vlerësuar po ashtu se jetëgjatësia në lindje përkundër që tregon rritje (70 vite në 2013 krahasuar me 67 në 1999), në raport me vendet tjera të rajonit është më e ulët (Serbia 74.5, Mali i zi 74.6, Maqedonia 74.8, Shqipëria 76.9 dhe Kroacia 76.6).

Në kuadër të kapitullit për **reagimet** apo **masat e ndërmarra** për përmirësimin e gjendjes së mjedisit janë trajtuar masat kryesore që janë ndërmarrë nga institucionet sikurse janë **hartimi i legjislacionit** mjedisor dhe **transpozimi** i tij me direktivat e BE-së, hartimi i strategjive dhe planeve mjedisore, sistemi i monitorimit të mjedisit, investimet në mjedis si dhe iniciativat regjionale dhe ndërkombëtare mjedisore. Konstatimet kryesore të nxjerra nga ky kapitull janë se Kosova ka një kornizë të mirë ligjore mjedisore dhe se në aspektin e përgjithshëm të transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin nacional arrin shkallën rreth 60%. Përveç masave ligjore, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe sektorëve relevantë mjedisore dhe me qëllim të zbatimit më efikas të politikave afatgjate mjedisore janë hartuar edhe **strategji, plane dhe programe** përkatëse.

Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit dhe mediumeve mjedisore, Kosova ka një **sistem të monitorimit të mjedisit** i cili përbëhet prej rrjeteve specifike monitoruese dhe prej formave tjera të monitorimit të bazuara në metodologji standarde, vëzhgim dhe vizita të rregullta monitoruese. Si rrjete të veçanta monitoruese janë rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit, rrjeti hidrometrik dhe ai për monitorimin e cilësisë së ujërave të lumenjve. Në pjesën e **investimeve në mjedis** prezantohet disa nga projektet kryesore mjedisore, burimet e financimit nga buxheti i Kosovës dhe burimet nga komuniteti i donatorëve. Kurse në pjesën e **bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë** janë prezantuar disa prej aktiviteteve, iniciativave dhe programeve në të cilat kanë marrë pjesë institucionet mjedisorë të Kosovës.

2. Forcat shtytëse (D)

Forcat shtytëse (Driving Forces) - në konceptet e mbrojtjes së mjedisit përshkruhen zhvillimet sociale, demografike dhe ekonomike në shoqëri dhe ndryshimet përkatëse në stilin e jetës, nivelet e përgjithshme të konsumit dhe të prodhimit. Forcat shtytëse kryesore janë rritja e popullsisë dhe zhvillimet në nevojat dhe aktivitetet e saj. Në fakt këto janë forcat kryesore që provokojnë ndryshime në nivelet e përgjithshme të prodhimit dhe konsumit. Përmes këtyre ndryshimeve në prodhim dhe konsum, forcat shtytëse ushtrojë presion mbi mjedisin.

2.1. Trendi demografik

Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe parashikimet- Pas Luftës së Dytë Botërore me përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe sanitare numri i përgjithshëm i popullsisë ka ardhur vazhdimisht duke u rritur (deri në fillim të shek. XXI), edhe pse emigrimet vazhduan me intensitet të ndryshëm gjatë gjithë periudhës për të arritur kulminacionin në 10 vjetshin e fundit të shek XX, kur vlerësohet se emigruan rreth 30 % e popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Si pasoj e emigrimeve masive dhe humbjeve në luftën e vitit 1999, popullsia e Kosovës për herë të parë në periudhën 1991-2011 karakterizohet me tendencë të zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë për -9.1%. Gjatë periudhës 63 vjeçare (1948-2011) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 138.2%.

Dendësia e popullsisë- Me rritjen e popullsisë së Kosovës është rritur edhe niveli i popullimit mesatar për njësi të sipërfaqes nga 62.7 (1948) në 167 (2013) banorë për km^2. Kjo rritje paraqet njëherësh edhe rritjen e ndikimit të popullsisë në mjedis. Dendësia më e lartë e popullsisë është në zonat e ulëta fushore (mbi 600 b/km^2-Fusha e Kosovës), në viset e ulëta kodrinore lëviz rreth mesatares së Kosovës, kurse viset e larta kodrinore-malore kanë dendësi më të ulët se mesatarja e Kosovës. Në viset e ulëta është koncentruar numri më i madh i popullsisë, objekteve industriale dhe urbanizimit, faktorë këta që kanë ndikimin më të madh në ndotjen e mjedisit.




Figura 2: Numri i përgjithshëm *i popullsisë dhe dendësia e saj* në Kosovë, *1948-2013*

Në bazë të projeksioneve të popullsisë së Kosovës numri i përgjithshëm do të vazhdon të rritet deri në gjysmën e parë të viteve të '30, të këtij shekulli, edhe pse me ritme dukshëm më të ngadalshme krahasuar me vitet e '60, '70 dhe '80 të shekullit të kaluar.

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ka ndikim në mjedis në shumë aspekte, prej të cilave më të rëndësishmet janë: ndikimi në shkallën e prodhimit, shfrytëzimin e resurseve, në mënyrën e shfrytëzimit të tokës si dhe krijimin e mbeturinave dhe ndotjen e mjedisit.

Shtimi natyror i popullsisë- Popullsia e Kosovës ritmin më të shpejtë të rritjes e ka pasur gjatë viteve '60-ta, kur shkalla e shtimit natyror ishte më e larta në periudhën e pas Luftës së dytë Botërore me 29.9‰ (lindshmëria 44.1‰ kurse vdekshmëria 14.2‰).




Figura 3: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 2002-2011

Në bazë të dhënave që ofron Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2003 në Kosovë është regjistruar niveli më i ulët i lindjeve dhe i shtimit natyror të popullsisë në 1000 banorë, që nga përfundimi i Luftës së dytë Botërore deri me sot.

Struktura e popullsisë sipas moshës- Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup mosha 0-19 vjeç përbën 38 %, grup mosha 20-64 përbën 56 %, kurse grup mosha e vjetër mbi 65 vjeç përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme.




Figura 4: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006

Struktura e popullsisë sipas moshës në mjedis ndikon përmes prodhimit dhe konsumit, sepse nga kjo strukturë formohet kontingjenti i punës dhe kontingjenti i popullsisë që paraqitet si konsumator.

Referenca dhe burime shtesë: ***Burime në internet:***

- *Regjistrimi i popullsisë 2011, ASK* — *www.ask.rks-gov.net*
- *Vlerësim-Popullsia 2013, ASK* — *www.worldbank.org/country/kosovo*
- *Raporti i zhvillimit njerëzor 2012, UNDP* — *www.ks-undp.org*

2.2. Urbanizimi

Edhe pse mjediset urbane në disa aspekte ofrojnë përparësi në krahasim me mjediset rurale (janë më kompakte, zënë sipërfaqe më të vogla për kokë banori, kanë efikasitet në shpërndarjen e ujit, rrymës, rrugëve dhe shërbime më të mira për mbeturina etj) ndikimi i tyre negative në mjedis është shumë më i madhë në krahasim me mjediset rurale. Sidomos ndikimi negative në mjedis rritet me emigrimet e pa kontrolluara të cilat shfaqen përmes: rritjes së dendësisë (mbipopullimi), të viseve urbane dhe depopullimit të viseve rurale, ndërtimet pa kritere urbanistike në periferi, me mungesë të infrastrukturës, vështirësi në strehim, në shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, hedhja e pa kontrolluar e hedhurinave të ndërtimeve, rritja e sasisë së ujërave të zeza që përfundojnë pa trajtim ne mjedisit natyrore. Pastaj vijnë edhe problemet socio-ekonomike siç janë: rritja e papunësisë, mungesa e shërbimeve cilësore shëndetësore, gjendja higjienike, mbingarkesa e institucioneve shkollore në qytete dhe braktisja e atyre në fshatra siç është rasti me zonat kodrinore-malore të Kosovës.

Komunikacioni në mjediset urbane është shumë më i dendur dhe është burim i madh i ndotjes së ambientit: ajrit për shkak të zhvillimit të vrullshëm të sektorit të transportit, të përdorimit në shkallë të madhe të automjeteve të vjetra, furnizimi i kufizuar me ujë, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëria ne qytete etj. Të gjithë këta faktorë ushtrojnë ndikimin e tyre edhe në cilësinë e ajrit dhe ujit të cilët janë tregues shumë të rëndësishëm të ndotjes së mjedisit.

Lëvizjet e popullsisë kanë ndikuar në ndryshimin e raporteve popullsi urban dhe rurale. Në periudhën 1948-1991 në Kosovë ka pasur rritje edhe të popullsisë urbane edhe të asaj rurale mirëpo rritja e popullsisë urbane është shumë më e shpejtë. Si pasoj e emigrimeve masive dhe humbjeve në luftën e vitit 1999, popullsia e Kosovës për herë të parë në periudhën 1991-2011 karakterizohet me tendencë të zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë për -13.8%, popullsisë urbane për -9.8 % dhe popullsisë rurale -16.1%[3]. Gjatë gjithë periudhës në vështrim popullsia rurale dominon në numrin e popullsinë së përgjithshme.

Në vitin 2011 popullsia urbane përbënte 38 % të popullsisë kurse ajo rurale 61.9% (1981-32.5%) , ndërsa në vitin 1948 popullsia urbane përbënte vetëm 9.7% të popullsisë së përgjithshme).

Në krahasim me vitin 1948 në vitin 2011 popullsia e përgjithshme tregon rritje për 137.3 %, popullsia rurale 62.9 %, kurse popullsia urbane tregon rritje prej 827.4 %. Pra trendët e rritjes se popullsisë urbane kanë qenë shumë me të shpejta se sa të popullsisë së përgjithshme dhe asaj rural.

3 Përveç komponentëve demografike në zvogëlimin e numrit të popullsisë ka ndikuar edhe ndryshimi i konceptit të regjistrimit të popullsisë në regjistrimin e vitit 2011.

Sa i përket pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme, popullsia urbane shkallën më të lartë të rritjes e arrin në periudhën 1961-71 dhe 1971-'81, kur përqindja e popullsish urbane rritet nga 19.5 % në 26.9%, respektivisht nga 26.9% në 32.5%.




Figura 5: % e popullsisë rurale dhe urbane në Kosovë 1948-2011

Krahas rritjes së popullsisë urbanë është rritur edhe sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimeve. Vetëm nga vitit 2002 deri në vitin 2012, vlerësohet që në Kosovë sipërfaqet e vendbanimeve janë rritur për rreth 8000 ha. (Figura 6). Krahasuar me vendet tjera të Evropës, Kosova ka dukshëm më pak sipërfaqe të banueshme (vendbanime), që përbëjnë vetëm rreth 4% të sipërfaqes së përgjithshme, ndërkohë që dendësia e banorëve për kilometër katrorë vlerësohet te jetë ndër më të lartat në Evropës me rreth 170 banorë për një km^2. (Figura 7).




Figura 6: Sipërfaqet e vendbanimeve (ha) 2002-2012[4]

4 *Burimi: Inventari i Pyjeve të Kosovës 2002 dhe 2012/APK*




Figura 7: Raporti në mes zonave të banuara dhe dendësisë së popullsisë në Kosovë dhe Evropë[5]

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Regjistrimi i popullsisë 2011, ASK*	*www.ask.rks-gov.net*
• *Vlerësim-Popullsia 2013*	*www.fiskos.org*
• *Inventari i Pyjeve të Kosovës 2012, APK 2013*	*www.eea.europa.eu/data-and-maps*

5 *http://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/land-take-2/assessment*

2.3. Zhvillimi socio-ekonomik

Kosova karakterizohet si vend në zhvillim. Që nga viti 2000 edhe të ardhurat për kokë banori edhe zhvillimi i përgjithshëm ekonomik kanë shënuar rritje progresive. Kjo më shumë për shkak të donacioneve të ndryshme por edhe për shkak të rimëkëmbjes së ekonomisë vendore.

Megjithkëtë Kosova ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Evropë. Gjithashtu hynë në radhën e shteteve me të ardhura më të ulëta edhe në nivel global.

Të dhënat e Bankës Botërore vlerësojnë se gjatë vitit 2013 Kosova ka pasur një rënie të ndjeshme të rritjes së përgjithshme të Bruto Prodhimit Vendor-BPV me 3% që është për rreth 0.4% më pak se në vitin paraprak, ndërkohë që Prodhimi i Brendshëm Bruto për kokë banori, ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak nga 3,506 dollarë sa ishte në vitin 2012 në 3,877 dollarë në vitin 2013.




Figura 8: Bruto Prodhimi Vendor-BVP për koke banori dhe Rritja e përgjithshme e BPV ne Kosove 2002-2013[6]

Sipas të dhënave të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë është 30%. Në varfëri ekstreme jetojnë 10.2% të popullsisë ndërsa që varfëria e përgjithshme është 29.7 %. Të ardhurat për kokë banori në vitin 2013 ishin 2.935 Euro.

6 www.worldbank.org/country/kosovo

Tabela 1: Disa treguesit socio-ekonomik të popullsisë së Kosovës

Papunësia				Varfëria		Të ardhurat
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	Shkalla e përgjithshme e papunësisë	Shkalla e papunësisë te meshkujt	Shkalla e papunësisë te femrat	Varfëria e përgjithshme	Varfëria ekstreme	Të ardhurat vjetore për banorë
40.5 %	30.0 %	26.9 %	38.8 %	29.7%	10.2%	2.935 Euro

Referenca dhe burime shtesë:

- *Statistikat e mirëqenies sociale 2014, ASK*
- *Anketa e fuqisë punëtore ne Kosovë 2013, ASK*
- *Raporti i zhvillimit njerëzor, UNDP 2010*

Burime në internet:

www.ask.rks-gov.net

www.worldbank.org/country/kosovo

www.ks-undp.org

2.4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

Një prej formave të ndikimit të drejtpërdrejtë në mjedis është edhe shfrytëzimi i resurseve natyrore. Format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore janë të ndërlidhura me shfrytëzimin e masës drunore, shfrytëzimin e ujërave por edhe shfrytëzimin e inerteve dhe mineraleve.

Të dhënat flasin se pjesa më e madhe e ujërave shfrytëzohen nga ujësjellësit publik për furnizim me ujë të pijes, për amvisëri dhe për nevojat e konsumatorëve tjerë të kompanive publike të ujësjellësve dhe kanalizimeve. Bujqësia konsiderohet po ashtu një sektor tjetër zhvillimorë ku shfrytëzohet uji, kryesisht për ujitjen e tokave bujqësore. Ne sektorin e energjisë uji përdoret për ftohje ndërsa në industri për prodhim dhe ftohjen e pajisjeve. (Figura 9).




*Figura 9: Sasia e ujit t*ë shpenzuar mi*lion m³/vit sipas sektorëve*[7]

Një formë tjetër e shpeshtë e shfrytëzimit të resurseve natyrore është shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare përmes seperacioneve. Sipas të dhënave nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në Kosovë kanë licencë për aktivitete të veçanta të seperacionit 107 operatorë ekonomike. Dominojnë operatorët e klasifikuar si sortues me 69% ose 74 sosh dhe ata të klasifikuar si bazë e betonit me rreth 24% ose 23 sosh , ndërsa që ata të llojit bazë e asfaltit me rreth 8% ose 9 sosh. (Figura 10).

7 *Të dhënat për shfrytëzimin e ujit nga ujësjellësit publik janë marrë nga Raportet e performacës së KUR, të dhënat për ujitje nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kurse të dhënat për shfrytëzimin e ujit në Energji dhe Industri nga Raportet vjetore te operatorëve: KEK, SharCem dhe NewCoFeronikel.*




Figura 10: Numri i operatoreve ekonomik qe kanë aktivitet seperacionin minerare[8]

Shikuar në aspektin e shtrirjes hapësinore vërehet se komuna e Prizrenit dhe Pejës kanë numrin më të madh të operatorëve ekonomike që si veprimtari kryesore kanë seperacionin e gurit ose mineraleve tjera.




Figura 11: Shpërndarja hapësinore e operatoreve ekonomik që kanë aktivitet seperacionin minerar

8 *Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (www.kosovo-mining.org)*

Një formë tjetër e shfrytëzimit të resurseve natyrore është edhe shfrytëzimi i inerteve/zhavorrit nga lumenjtë. Ky shfrytëzim ka ardhur si rezultat i kërkesës dhe nevojës për ndërtim dhe zhvillim ekonomik. Mirëpo në shumë lumenj të vendit shfrytëzimi i inerteve është bërë pa kriter dhe i ka tejkaluar kapacitetet e shtretërve të lumenjve. Ky mbi shfrytëzim është përcjellë me pasoja jo vetëm në ekosistemin e lumit dhe shtratit të tij por edhe me paraqitjen e vërshimeve dhe përmbytjeve të lumenjve. Duke u bazuar nga të dhënat e inspektoratit mjedisor dhe nga vizitat e realizuara në terren nga AMMK vlerësohet se gjendja mjedisore e lumenjve vazhdon të përkeqësohet nga eksploatuesit e rërës. Lumenjtë më të degraduar dhe që ende vazhdojnë te degradohen janë: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Ereniku, Lumi Desivojcë, Lumi Krivareke dhe Ibri. (Tabela 2).

Tabela 2: Sipërfaqet e degraduara sipas lumenjve[9]

Lumi	**Sipërfaqja ha 2009**	**Sipërfaqja ha 2012**
Drini i Bardhë	861.1	1011.75
Ibri	2.64	4.5
Morava e Binçës	4.29	4.79
Lumëbardhi i Pejës	93.36	134.5
Ereniku	16.28	19.48
Desivojca	7.76	18.95
Total	**1004.77**	**1219.23**

Me qëllim të parandalimit të këtij degradimi, Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2011 ka nxjerr një vendimin[10] i cili ndalon shfrytëzimin dhe eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në të gjithë territorin e vendit. Ky vendim ka filluar së implementuari nga MMPH dhe institucionet tjera relevante gjatë vitit 2012. Megjithëkëtë, përkundër zbatimit të masave për implementimin e këtij vendimi dhe aktiviteteve tjera që janë zbatuar me qëllim të ndalimit të degradimit të lumenjve dhe eksploatimit të inerteve mund të vlerësohen se deri me tani nuk janë arritur rezultatet e synuara.

Shfrytëzimi i masës drunore nga pyjet qoftë për djegie apo edhe për qëllime tjera është një nga format e shfrytëzimit të resurseve natyrore që ka ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen e mjedisit kur dihet roli dhe rëndësia që kanë pyjet në cilësisë e ajrit, rregullimin e regjimit ujor por edhe për klimën.

Sipas inventarit nacionale të pyjeve (tabela 3), në Kosovë mesatarisht gjatë një viti priten rreth 1.6 milion m^3 dru, të cilat shfrytëzohen si lëndë djegëse ose edhe për nevoja tjera. Nga kjo sasi rreth 1.0 milionë m^3, priten në pyje publike dhe 560 000 m^3 në pyjet private.

9 *GFO2014, Degradation of rivers in Kosovo; Integrating ecological knowledge into nature conservation and ecosystem management, 44th annual meeting, Semptember 8-12 th, 2014, Hildesheim, Germany*

10 *Vendimi nr.02/46 i Qeverisë së Kosovës*

Tabela 3: Mesatarja e prerjes vjetore në pyje sipas llojeve të drurit dhe pronësisë (1000 m^3) sipas matjeve provë në 60% të territorit të Kosovës.

Lloji i drurit	Pronësia			Totali
	Panjohur	Publike	Private	
Halorë	0	123	12	135
Fletorë	2	496	326	823
Totali	2	619	338	959

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ujërave 2015, AMMK*	*www.ammrk-rks.net*
• *Inventari Nacional i Pyjeve 2012, APK*	*www.fiskos.org*
• *Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale*	*www.kosovo-mining.org*

2.5. Përdorimi tokës dhe mbulushmëria e saj

Përdorimi i tokave- Bazuar në rezultatet kryesore të Inventarin Nacional të Pyjeve për vitin 2012, është konstatuar se pyjet dhe tokat pyjore përfaqësojnë kategorinë kryesore të shfrytëzimit të tokave me rreth 47%, tokat bujqësore me rreth 29%, livadhet dhe kullosat me 15%, vendbanimet me rreth 4.5%, ujërat dhe tokat e lagura me rreth 0.6% kurse tokat tjera me rreth 3.9%. Krahasuar me inventarin e realizuar për vitin 2002, konstatohet se janë rritur sipërfaqet e tokave të përdorura si pyje, tokat e përdorura si livadhe dhe kullosa dhe tokat e përdorura si vendbanime. Ndërsa që janë zvogëluar sipërfaqet e tokave që përdoren si toka bujqësore dhe sipërfaqet e tokave tjera.




Figura 12: Përdorimi i tokës (ha) sipas kategorive 2002 dhe 2012[11]

Mbulushmëria e tokave- Sipas të dhënave nga imazhet satelitore të vitit 2012, që janë përpunuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të projektit Implementimi i CLC[12], 2012 në vendet e Ballkanit Perëndimor, i mbështetur nga Agjencia e Mjedisit të Evropës, në Kosovë janë identifikuar 28 klasa të mbulushmërisë së tokave nga 44 sa ka gjithsej nomenklatura CORINE[13].

Këto klasa janë grupuar në 4 klasa kryesore ky dominojnë pyjet dhe zonat gjysmë-natyrore me rreth 57% dhe tokat bujqësore me rreth 40 %, ndërsa që tokat artificiale përfaqësohen me mbi 3.0% të totalit. Rreth 0.3 % e tokave të mbuluara klasifikohen në klasën e trupave ujorë dhe zonave të lagura (ligatinat)[14].

11 *Inventari i Pyjeve të Kosovës 2012/APK*
12 *CLC- Corine Land Cover (Mbulushmeria e tokave sipas metodoligjisë CORINE)*
13 *Coordination of information on the environment/Koordinimi i të dhënave në mjedis*
14 *Implementation of CLC2012 in the West Balkan Countries/EEA 2014*




Figura 13: Mbulushmeria e takova (%) sipas kategorive për vitin 2012[15]

15 *AMMK, projekti implementimi i CLC per vitin 2012*




Figura 14: Harta e mbulushmërisë së tokave sipas metodologjisë Corine (CLC) në Kosovë për vitin 2012 (Burimi:AMMK)

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Inventari Nacional i Pyjeve 2012, APK*	*www.ammrk-rks.net*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.fiskos.org*
• *Regjistrimi i Bujqësisë 2014, ASK*	*www.esk-rks-gov.net*
	www.eea.europa.eu/data-and-maps

3. Presionet (P)

Presionit në mjedis përshkruajnë zhvillimet në mjedis që rezultojnë me lirimin e substancave (emetimeve), fizike dhe biologjike, përdorimin e burimeve dhe përdorimin e tokës gjatë aktiviteteve njerëzore. Presionet e ushtruara nga shoqëria paraqesin një shumëllojshmëri të proceseve që manifestohen në ndryshimin e kushtet mjedisore. Shembuj të presionit në mjedis janë emetimet e CO_2 në atmosferë, përdorimi i zhavorrit dhe rërës për ndërtimin ose edhe përdorimi i tokës për ndërtimin e rrugëve.

Presionet ne mjedis munde te trajtohen edhe sipas sektorëve te caktuar zhvillimore. Presionet sektoriale, pasqyron presionet në mjedis të sektorëve të caktuar ekonomik dhe sektorëve tjerë, përmes të cilëve njeriu duke kënaqur nevojat e veta socio-ekonomike shkakton ndikime të ndjeshme në mjedis. Shfrytëzimi i hapësirës, shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe llojet e ndryshme të shërbimeve të cilat kanë ndikim në mjedis, reflektohen edhe në ndryshimin e baraspeshës natyrore, harxhimin e resurseve natyrore dhe në shëndetin e njeriut. Përmasat e këtyre ndikimeve, mekanizmi i veprimeve dhe pasojat në mjedis janë të varura nga shumë faktorë. Mosndërmarrja e masave adekuate në parandalimin dhe eliminimin e tyre në shumicën e rasteve shkaktojnë efekte të pariparueshme për mjedisin.

Me qëllim të vlerësimit më të lehtë të ndikimeve në mjedis, praktikohet që efektet sektoriale të grupohen sipas aktiviteteve ekonomike, që në realitet trajtohen si sektorë të veçantë.

Disa aktivitete ekonomike si: energjetika, industria, transporti, etj. padyshim janë burime me ndikim të theksuar në mjedis, ndërsa bujqësia, pylltaria etj. qëndrojnë në raporte të tjera me mjedisin dhe si të tilla varen mjaft nga gjendja e mjedisit. Shqyrtimi i ndikimeve të tyre në mjedis, assesi nuk duhet të anashkalohet. Ndërsa, turizmi është një sektor ekonomik, efektet e të cilit në mjedis janë identifikuar kohëve të fundit.

Shqyrtimi i ndikimeve të sektorëve në mjedis ka një përparësi sidomos gjatë planifikimeve zhvillimore dhe hartimit të strategjive përkatëse. Përveç shqyrtimit të efekteve sektoriale veç e veç, është me interes edhe shqyrtimi i zonave në të cilat vjen deri te ndikimi i veprimeve të përbashkëta të disa sektorëve të ndryshëm. Kimikatet i takojnë këtij grupi, prodhimi dhe përdorimi i të cilave sot është në rritje e sipër nga disa sektorë.

3.1. Energjia

Energjetika luan rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në jetën e modernizuar të njeriut. Por edhe ndikimet e saj në mjedis janë mjaft të theksuara. Çfarëdo qoftë mënyre e prodhimit të energjisë ka ndikim të ndjeshëm në mjedis, për shkak të operacioneve të cilat e përcjellin, që nga sigurimi i lëndës së parë dhe transportit të saj e deri te procesi i prodhimit dhe vet shfrytëzimi i energjisë. Arritja e një baraspeshe në mes kërkesës për energji dhe ruajtjes së gjendjes së mjedisit është një sfidë e madhe. Duke zgjedhur llojet e burimeve të energjisë dhe teknologjive të përshtatshme zvogëlohet ndikimi në mjedis.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013-2022 është dokumenti themelor që përcakton politikat e energjisë dhe synimet zhvillimore të këtij sektori në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, ruajtjes së mjedisit dhe mirëqenies sociale, duke rritur profitin nga shfrytëzimi i resurseve energjetike vendore[16].

Në Kosovë, sektori i energjisë vlerësohet se është sektori që ka ndikimin më të madh në mjedis. Thëngjilli me 65 % ka pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të burimeve primare energjetike në dispozicion për vitin 2013. Linjiti përfaqëson rreth 97 % nga totali i thëngjillit që përdoret si burim primar i energjisë. Burimet e ripërtritshme të energjisë (era, energjia solare dhe hidroenergjia), përfaqësojnë vetëm rreth 10% të burimeve primare energjetike në dispozicion.[17]




Figura 15:Burimet primare të energjisë në dispozicion 2013[18]

16 *Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2013-2022*
17 *Balanca e Energjisë 2013 , MZHE*
18

Po ashtu nëse e analizojmë trendin e burimeve primare energjetike në dispozicion do të vërejmë se thëngjilli vazhdon të shënojë trend në rritje, ndërkohë qe burimet e ripërtritshme të energjisë përkundër rritjes ende mbesin në nivel të ulët (figura 16).




Figura 16: Konsumi i energjisë primare (ktoe) sipas llojit të lëndës djegëse *(karburantit) 2003-2013*[19]

Njëjtë ndodh edhe në pjesëmarrjen e energjisë së renovueshme në kuadër të prodhimit total të energjisë, ku prodhimi i energjisë së renovueshme merr pjesë vetëm me rreth 10 ktoe, krahasuar me rreth 2500 ktoe prodhim total të energjisë (Figura 17).




Figura 17: Raporti në mes të prodhimit total të energjisë elektrike dhe energjisë së renovueshme 2000-2013[20]

Për të analizuar ndikimin e sektorit të energjisë në mjedis në rend të parë duhet analizuar emisionet e përgjithshme nga procesi i prodhimit të energjisë duke përfshirë: ndotjen e ujit, ajrit, tokës, menaxhimin e mbetjeve, zhurmën dhe radioaktivitetin.

19 *Balancet e Energjisë 2002-2013, MZHE*
20 *Po aty*

Korporata Energjetike e Kosovës, si operatorë kryesor në prodhimin e energjisë përmes TCA dhe TCB, përgatitë raporte mujore për gjendjen e mjedisit përmes së cilave prezantohen edhe ndikimet mjedisore. Duke analizuar të dhënat për emisionet e pluhurit nga TCA dhe TCB për periudhën kohore 2007-2014, vërejmë se nga TCA ka pasur rënie të vazhdueshme të emisioneve të pluhurit ndërsa që në TCB ka pasur rritje të emisioneve të pluhurit (Figura 18). Kjo rënie e emisioneve të pluhurit nga TCA mundë të arsyetohet nga investimet në vendosjen e elektrofiltrave që janë bërë në këtë termocentral, ndërsa ngritja e emisioneve në TCB me vjetrimin e elektrofiltrave të këtij termocentrali.




Figura 18. Vlerat mesatare vjetore të pluhurit në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014[21]

Në figurën 18 janë prezantuar emisionet e SO_2, në të dy termocentralet: TCA dhe TCB për periudhën kohore 2007-2014. Krahasuar me vitin 2010, vërehet se emisionet e SO_2 kanë qenë me të ulëta në dy TC, edhe pse në TCA vërehet një rënie më e madhe e emisioneve të SO_2. Ndërsa që tek emisionet e NOx, nuk vërehet ndonjë ndryshim në rënien e emisioneve (figura 20).

21 *Raportet mujore dhe vjetore mjedisore të Departamentit të Mjedisit të KEK*




Figura 19. Vlerat mesatare vjetore të SO_2 në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014[22]




Figura 20. Vlerat mesatare vjetore të NO_x në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014[23]

Në zonën e Obiliqit, për shkak të ndikimit të prodhimit të Energjisë në cilësinë e ajrit bëhet edhe monitorimi i vazhdueshëm përmes tri stacioneve që janë të vendosura në Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj. Këtoo stacione janë me sfond industrial dhe menaxhohen nga IHMK. Vlerat e parametrave të monitoruar (SO_2, NOx, O_3, PM10 dhe CO) për vitet 2003 dhe 2004, janë prezantuar në tabelën 4.

22 *Po aty*

23 *Raportet mujore dhe vjetore mjedisore të Departamentit të Mjedisit të KEK*

Tabela 4: Të dhënat për cilësinë e ajrit në zonën e KEK sipas monitorimit nga IHMK[24]

Stacionet monitoruese	2013					2014				
	SO_2 (ug/m³)	NO_x (ug/m³)	O_3 (ug/m³)	CO (mg/m³)	PM10 (ug/m³)	SO_2 (ug/m³)	NO_x (ug/m³)	O_3 (ug/m³)	CO (mg/m³)	PM10 (ug/m³)
Obiliq	7.89	13.92	48.3	0.630	53.1	19.59	29.57	64.7	0.92	48.6
Dardhishte	8.3	12.31	56.3	0.700	52.8	11.63	12.47	22.70	0.63	44.24
Palaj	5.4	6.7	54.4	0.480	48.3	18.97	9.32	30.8	0.79	37.99
Vlerat e lejuara vjetore	125	200	120	10	40	125	200	120	10	40

Nga tabela shihet se tejkalime të vlerave të lejuara brenda vitit (40 ug/m³) për PM10 për vitin 2013 janë regjistruar në të tri stacionet, kurse për vitin 2014 në stacionet në Obiliq dhe Dardhishtë. Parametrat tjerë kanë qenë brenda vlerave limite kufitare. (Për më shumë shiko kapitullin e ajrit).

Bazuar në të dhënat e prezantuara për cilësinë e ajrit si dhe për emisionet në ajër, mundë të konkludohet se në rajonin e Obiliqit ka përmirësim të gjendjes së mjedisit. Kjo më së shumti për faktin se Në TC Kosova A është bërë instalim i elektrofilterëve në TC A3, TC A4 dhe TC A5. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat nga matjet e emetimit të pluhurit, vlerat e të cilit kanë arritur në vlerat e lejuara për emetim të pluhurit, siç e parasheh Udhëzimi Administrativ Nr.06/2007 për shkarkimet nga burimet stacionare. Është instaluar edhe sistemi i monitorimit kontinual të emisioneve në Termocentralin Kosova B (Pluhuri, SO_2 dhe NO_x). Gjithashtu ka përmirësime edhe në menaxhimin e mbetjeve të hirit pasi që ka përfunduar projekti për transportin hidraulik të tij nga deponia e TC Kosova A dhe tani e gjithë sasia e hirit nga të gjitha Termocentralet e KEK-ut deponohen ne hapësirat e zbrazura të Mihjes Sipërfaqësore të Mirashit. Kurse në kuadër të projektit për pastrimin dhe largimin e mbetjeve të rrezikshme (uji fenolik, katrani, di-izopropiletri, vaji i mesëm etj.) nga Reparti i Gazifikimit, sipas raporteve vjetore të Departamentit të Mjedisit në KEK, kanë mbetur vetëm një sasi e vogël e këtyre materieve, pasi që pjesa më e madhe e tyre janë dërguar për trajtim jashtë vendit.

Me qëllim që të vazhdohet me përmirësimi i gjendjes së mjedisit në zonën e Obiliqit, nevojitet që të vazhdohet edhe më tutje në përmirësimin e teknologjisë në vargun e procesit të prodhimit të energjisë, menaxhimi më i mirë i mbetjeve dhe trajtimi i tyre sikurse janë mbetjet e vajrave industriale.

Në nivelin kombëtarë sa i përket sektorit të energjisë kërkohet që të vazhdohet me investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme, të promovohet dhe mbështetet edhe më shumë efiçenca e energjisë si dhe të respektohen kriteret dhe standardet mjedisore ne procesin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike.

24 *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

Kërkohet po ashtu edhe përmirësimi i monitorimit të emisioneve në mjedis nga sektori i energjisë.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ajrit 2013, AMMK*	*www.ammk-rks.net/ajri*
• *Cilësia e ajrit ne zonën e KEK 2013, AMMK*	*www.mzhe.rks-gov.net*
• *Balanca e Energjisë 2002-2013, MZHE*	*www.kek-energy.com*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

3.2. Industria

Industria është çelësi i zhvillimit ekonomik të një vendi, por njëkohësisht hynë në radhën e ndikuesve më të mëdhenj në mjedis. Përmes zhvillimit të industrisë harxhohen resurset si: burimet energjetike, uji dhe resurset tjera. Nga aktivitetet industriale lirohen emisione në ujë, ajër dhe tokë. Fatkeqësitë industriale paraqesin një tjetër kërcënim të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ndërsa, prodhimi i mbeturinave nga shumica e industrive është edhe një segment tjetër i ndikimit të këtij sektori në mjedis.

Zhvillimi industrial i Kosovës është mbështetur gati ekskluzivisht në shfrytëzimin e resurseve natyrore (thëngjilli, xehet metalike, xehet jometalike etj.) Ky zhvillim në të kaluarën karakterizohej me eksploatim intensiv të resurseve natyrore duke ndërtuar kapacitete të mëdha (vitet '70 e '80 të shekullit të kaluar) por me teknologji jo bashkëkohore e aspak miqësore për mjedisin. Megjithatë ndikimi i tyre në Bruto Produktin Vendor ishte mjaft i lartë (deri në 50 %) ngase kontribuues ishin energjetika, metalet me ngjyrë dhe përpunimi i metaleve.

Struktura e industrisë dhe teknologjia e tyre ishte dhe vazhdon të jetë e pavolitshme, ngase dominon industria ekstensive e mbështetur në shfrytëzimin e thëngjillit dhe xeheve metalike. Shumë produkte nga industria që do të mund të prodhoheshin edhe në Kosovë, sot importohen nga jashtë. Ndërmarrjet shoqërore të privatizuara, përveç Sharrcemit dhe Feronikelit, nuk janë në funksion ose operojnë me vështirësi për shkak të teknologjive të vjetruara dhe mungesës së financimeve në teknologji. Ndikimet në mjedis nga ndërmarrjet e tilla janë të theksueshme, si në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe gjenerimit të mbetjeve. Mbetjet e trashëguara nga veprimtaria e industrisë nga periudha e kaluar janë të shumta dhe kërkojnë investime për rehabilitimin e tyre.

Në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ekziston Departament i Industrisë, i cili propozon dhe harton dokumentet e politikave sektoriale dhe nën-sektoriale, legjislacionin dhe masat për avansim të industrisë si dhe siguron zbatimin e politikave për zhvillimin industrial në Kosovë. Nuk mund të flitet për ndonjë dokument të veçantë për politika nacionale të këtij sektori, por ato janë pjesë e Programeve qeveritare. MTI ka hartuar një Koncept të Politikave për Industrinë e Kosovës (PIK) 2014-2020 e ndërlidhur me politikat specifike sektoriale bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2020. Disa nga objektivat e përbashkëta të këtyre Strategjive janë: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rritja e të ardhurave, përmes zhvillimit të kapaciteteve, përmirësimit teknologjik dhe përdorimit efikas të resurseve natyrore.

Ndërsa në kuadër të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022 në kapitullin për Industrinë si objektiva mjedisore për këtë sektorë janë *përcaktuar: përmirësimi* i performancës mjedisore të njësive industriale përmes zbatimit të sistemeve të menaxhimit të mjedisit, krijimit të mekanizmave lehtësues për përmbushjen e standardeve mjedisore dhe inkurajimit për përmirësimin dhe avancimin e procesit të prodhimit përmes aplikimit të praktikave të mira dhe teknologjive të pastra[25].

Nga aktivitetet industriale, shfrytëzimi i mineraleve, linjitit, prodhimi i materialeve ndërtimore, prodhimi i çimentos, përpunimi i gomës, plastikës, përpunimi i ushqimit, prodhimi i pijeve joalkoolike etj. shkaktohen ndikime në mjedis(ujë, ajër, tokë, gjenerimi i mbeturinave, emetimi i zhurmës dhe efektet në ekosisteme). Të shoqëruara me emisione në ajër (SO_2, NO_x, Pluhur dhe CO_2) aktivitetet industriale rrisin ndikimin në mjedis edhe për shkak të pjesëmarrjes në ndryshime klimatike. Shkarkimet e ujërave të patrajtuar në rrjedhat e lumenjve dhe zënia e sipërfaqeve të tokës për deponim të mbetjeve industriale janë presione direkte që ndikojnë ne mjedis dhe në shëndet publik.

Në mungesë të të dhënave nga operatorët tjerë aktiv në kuadër të këtij sektori, do të prezantohen të dhëna për emisione nga prodhimtaria e çimentos SharrCem në Han të Elezit dhe Kompleksi Industrial NewCo Ferronikeli Complex L.L.C.

Të dhënat për vlerat mesatare vjetore të emisioneve të pluhurit nga NewCoFeronikeli janë prezantuar në figurën 21. Sikurse vërehet nga figura gjatë vitit 2013 ka pasur tejkalime për këto emisione ndërsa në vitin 2014 nuk ka pasur tejkalime te vlerave të lejuara. Tejkalime të vlerave mesatare vjetore për ka pasur edhe për emisionet e SO_2 për vitin 2013 ndërsa që për emisionet e NOx nuk ka pasur tejkalim të vlerave të lejuara vjetore (figura 22). Në të dy figurat vërehet se në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 ka rënie të dukshme të vlerave mesatare vjetore të emisioneve.

25 *Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, MMPH*




Figura 21: Vlerat mesatare vjetore te emisioneve te pluhurit në furrat rrotulluese të NewCoFeronikeli 2013-2014[26]




Figura 22: Vlerat mesatare vjetore te emisioneve te SO_2 dhe NO_x në furrat rrotulluese të NewCoFeronikeli 2013-2014[27]

Të dhënat për emisionet e pluhurit nga SharrCemi janë prezantuar në figurën 23. Nga të dhënat konstatohet se gjatë viteve 2012-2014, ka rënie të dukshme të vlerave mesatare vjetore për emisionet e pluhurit dhe nuk janë regjistruar tejkalime. Edhe të dhënat për emisionet e SO_2 dhe NOx, nga SharCemi për periudhën kohore 2003 deri ne 2014 që janë prezantuar në figurën 24 tregojnë se gjatë viteve 2011-2014, nuk ka pasur tejkalime te vlerave mesatare vjetore për NOx, ndërsa që për emisionet e SO_2, janë regjistruar tejkalime të këtyre vlerave në vitet 2010, 2011 dhe 2013. Shikuar nga aspekti më afatgjatë që nga viti 2003 deri në vitin 2014, shihet që ka pasur rënie të vazhdueshme të emisioneve të SO_2 dhe NO_x.

Të dhënat për cilësinë e ajrit nga monitorimi i IHMK-së, për stacionin e Hanit të Elezit, që është i vendosur në zonën e ndikimit të Fabrikës së SharrCemit, janë prezantuar në kapitullin e ajrit.

26 *Raporti vjetor 2013/2014, Departamenti i mjedisit, NewCoFeronikeli*
27 *Po aty*




Figura 23: Vlerat mesatare vjetore e pluhurit në SharrCem gjatë viteve 2003 – 2014[28]




Figura 24: Vlerat mesatare vjetore te SO_2 dhe NOx në Sharr*Cem gjatë viteve 2003 – 2014*[29]

Me qëllim të zvogëlimit dhe parandalimit të ndotjes së mjedisit nga sektori i Industrisë rekomandohet që industria të fokusohet në përmirësimin e perfomancës mjedisore përmes zbatimit të sistemeve të menaxhimit të mjedisit, menaxhimit të mbetjeve dhe trajtimit të ujërave të përdorura si dhe në avancimin e procesit të prodhimit përmes aplikimit të praktikave të mira dhe teknologjive të pastra. Ndërsa institucionet duhet të angazhohen që të krijojnë mekanizmave lehtësues për përmbushjen e standardeve mjedisore dhe lehtësira dhe mbështetje për industritë në përmirësimin e teknologjive të prodhimit.

28 *Raportet vjetore të SharrCem 2003-2014*
29 Po aty

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ajrit 2013, AMMK*	*www.ammk-rks.net/ajri*
• *Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022, MMPH*	*www.mmph-rks.org*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

3.3. Transporti

Ky sektor ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit, posaçërisht në mjediset urbane. Shumica e automjeteve përdorin naftën, çka nënkupton lirim të emisioneve në ajër, ujë dhe tokë. Gjithashtu, gjatë ndërtimit të rrugëve bëhen ndryshime të peizazhit dhe të tokave, përfshirë këtu edhe degradimin e mundshëm të habitateve. Automjetet e papërdorshme paraqesin po ashtu një rrezik serioz për mjedisin. Nga transporti i materieve të rrezikshme mund të vijë edhe deri të aksidentet me pasoja fatale për mjedisin.

Në kuadër të hartimit të politikave sektorale Qeveria e Kosovës ka hartuar dhe miratuar edhe Strategjinë e Transportit Multimodal dhe Planin e Veprimit. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është të kontribuojë në rritjen ekonomike përmes krijimit të sistemit të transportit multimodal (rrugor, hekurudhor dhe ajror) të integruar, efikas, dhe me kosto të ulët dhe i cili nuk e rrezikon mjedisin. Në kuadër të kësaj strategjie janë paraparë dhe ndikimet mjedisore që mund të vijnë si pasojë e zhvillimit të projekteve infrastrukturore. Qasja ndaj mbrojtjes së mjedisit te kjo strategji është na harmoni me Ligjit nr. 03/L-025 për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit ku përcaktohet qartë që për të gjitha projektet infrastrukturore, paraprakisht të kryhen dhe vlerësimet strategjike mjedisore, gjë që do të bënte të mundur harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenien sociale përmes parimeve themelore mbi mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Faktorët mjedisorë që identifikohen në këtë dokument dhe që konsiderohet që duhet të kihet parasysh në mbrojtjen e tyre para se të merret ndonjë vendim për zhvillimin e ndonjë projekti infrastrukturor janë edhe zonat e mbrojtura, ku potencohet se këto zona nuk duhet të kenë asnjë lloj ndikimi në aspektin e dëmtimit të ekosistemeve, pastaj faktori hidrologjik, rrëshqitjet e dheut, ndotja e ajrit, menaxhimi i mbeturinave etj[30].

Në Strategjinë për Ndryshime Klimatike (SNK) 2014 - 2024, në kuadër të masave të propozuara në këtë sektor janë: zvogëlimi i emisioneve të gazrave serrë, zvogëlimin e zhurmës dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore të favorshme për mbrojtje të mjedisit. Ndërsa në Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, si objektivë kryesore për zvogëlimin e ndikimit në mjedis nga sektori i transportit

30 *Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit 2012- 2021*

është përcaktuar që të projektohet, zhvillohet dhe operacionalizohet një sistem i qëndrueshëm dhe i sigurt i transportit në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Rritja e popullsisë në Kosovë dhe shtimi i nevojës për lëvizje dhe mjete të lëvizjes, konsiderohet si forcë kryesore shtytës në zhvillimin e këtij sektori dhe rritjes së ndikimit të tij në mjedis. Ndërsa shtimi i numrit të veturave, cilësia e dobët e derivateve vlerësohen si forca shtytëse që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit dhe mjedisit në përgjithësi.

Transporti ndikon në mjedis edhe përmes zënies së sipërfaqeve dhe ndërrimit të destinimit të përdorimit të tokave bujqësore dhe tokave tjera.

Rrjetit i transportit rrugorë në Kosovë përbëhet nga transporti rrugorë me 78 km autoudhë, 631 km rrugë magjistrale dhe 1.295 mm rrugë rajonale. Sikurse vërehet edhe nga figura 25, vetëm gjatë periudhës kohore 2010-2013, janë shtuar 80 km rrugë të reja, pjesa më e madhe e të cilave në kategorinë autoudhë. Shndërruar në hektarë llogaritet që vetëm nga kjo rrugë janë zënë më shumë se 230 ha kryesisht sipërfaqe e tokës bujqësore dhe pyjore.




Figura 25: Rrugët e Kosovë 2010-2013

Në Kosovë si mjet kryesorë i transportit përdoren veturat ku, kjo vjen si pasojë e mos funksionimit adekuat të transportit urban i cili operon me autobusë të vjetruar të cilët janë shumë të ngadalshëm dhe shkaktojnë shumë ndotje. Sikurse shihet nga figura që nga viti 2006 e deri në vitin 2014 ka pasur një rritje progresive të numrit të automjeteve në Kosovë. Nga kjo mundë të konkludohet që po ashtu ka pasur edhe një rritje të djegies së karburanteve nga këto makina që domosdoshmërisht ka rritur edhe sasisnë e ndotësve në ajër. Sipas Inventarit te Gazrave serrë të vitit 2012 transporti rrugore kontribuon me 12% në totali i emisioneve nga sektori i energjisë dhe është sektori i dytë në vend pas industrisë energjetike që emeton 75% të emisioneve.




Figura 26: Numri i automjeteve në Kosovë 2006-2014[31]

Si mjetë transporti ndër urban shfrytëzohet edhe treni. Kosova ka 333 km rrjet hekurudhorë. Që nga viti 2015 e deri në vitin 2013 ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit të udhëtarëve që shfrytëzojnë trenin për udhëtim.




Figura 27: Trendi i shfrytëzimit të transportit hekurudhorë[32]

Për transport ndërkombëtarë në Kosovë kryesisht shfrytëzohet transporti ajror. Sipas të dhënave të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës "Adem Jashari", për periudhën kohore 2006-2013 numri i udhëtarëve dhe numri i fluturimeve ka shënuar rritje progresive. Në figurën 27 është prezantuar trendi i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar transportin ajror përmes ANP. Nga figura shihet që nga rreth 90 mijë sa ishte numri i udhëtarëve në vitin 2006, në vitin 2013 është rritur në mbi 1600 mijë.

31 *Statistikat e transportit dhe telekomunikacionit 2015, ASK*
32 *Po aty*




Figura 28: Trendi i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari[33]

Me qëllim të zbutjes së presioneve në mjedis që vijë nga sektori i transportit rekomandohet të ndërmerren këto masa: shfrytëzimi i lëndëve djegëse më cilësore, shfrytëzimi i transportit alternativ që shkakton ndotje më të vogël të mjedisit, kufizim kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë, zbatimi i normave të lejueshme të zhurmës nga automjetet, rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe zgjidhja e problemit të automjeteve të vjetruara dhe të hedhura.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Emetimi i gazrave serre në Kosovë 2009, UNDP*	*www.ammk-rks.net/raporte*
• *Statistikat e transportit dhe telekomunikacionit 2015, ASK*	*www.mmph-rks.org*
• *Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022, MMPH*	*www.esk.rks-gov.net/transporti*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.mi-ks.net*

33 *Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës "Adem Jashari"*

3.4. Bujqësia

Pas vitit 2000 në Kosovë ka qenë e theksuar tendenca e rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe po ashtu, edhe tendenca e ndryshimit të zhvillimit të bujqësisë. Është shtuar numri i fermave dhe prodhuesve bujqësorë. Është shtuar përdorimi i fertilizerëve, kimikateve dhe i produkteve tjera kimike me ndikim në mjedis. Mirëpo edhe përkundër këtyre zhvillimeve interesimi për prodhimin e produkteve ekologjike (organike) është ende në nivel të ulët.

Në Planin Nacionale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-2013, në kuadër të masave të propozuara për këtë sektor është planifikuar edhe masa: mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës dhe përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore[34]. Ndërsa në kuadër të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, në kapitullin e Bujqësisë në kuadër të objektivave zhvillimore është paraparë edhe mbrojtja dhe përdorimi racional i tokave bujqësore, mbështetja për prodhimtarinë organike, kontrolli i përdorimit të plehrave dhe pesticideve dhe mbrojtja e llojeve autoktone të bimëve dhe kafshëve të rrezikuara.[35]

Gjithashtu, Strategjia për Ndryshime Klimatike, në kuadër të masave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike ka paraparë edhe adaptimin ndaj ndryshimeve në sektorin e Bujqësisë, ndërkohë që në kuadër të aktiviteteve për kompletimin e Inventarit të gazrave serrë janë inventarizuar edhe gazrat e serrës nga sektori i Bujqësisë.

Rritja e popullsisë dhe shtimi i nevoja për ushqim, konsiderohet si forca kryesore shtytëse në zhvillimin e këtij sektori dhe rritjes së ndikimit të tij në mjedis. Ndërsa që zgjerimi i vendbanimeve dhe urbanizimi vlerësohen si forcat shtytëse që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e sipërfaqeve bujqësore.




Figura 29: Sipërfaqet e tokave bujqësore (ha) 2002-2012[36]

34 *Plani për bujqësi dhe zhvillim rural, 2010-2013, MBPZHR*
35 *Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022.*
36 *Inventari i Pyjeve të Kosovës 2002 dhe 2012, APK*

Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore dhe ndërrimi i destinimit të përdorimit të tyre, mbetet një ndër problemet kyçe të sektorit. Sipas të dhënave nga Inventari i Pyjeve të Kosovës të viteve 2002 dhe 2012, rezulton që sipërfaqet e tokave bujqësore janë zvogëluar në mënyrë progresive. Nga rreth 342400 ha sa ishin në vitin 2002, në vitin 2012 janë regjistrua 309000 ha, që vlerësohet që gjatë kësaj periudhe kohore mesatarisht rreth 3000 ha për vit të tokave bujqësore janë zvogëluar ose kanë ndërruar destinimin e tyre. (Figura 29)

Presionet kyçe në mjedis nga sektori i bujqësisë janë sidomos nga përdorimi i plehrave kimike, pesticideve dhe kemikateve tjera bujqësore. Sipas të dhënave nga pyetësorët e bujqësisë të realizuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2013 janë përdorur rreth 80334 ton fertilizer që në përmbajtjen e tyre kanë Azot (NPK, UREA dhe NAG). Nga kjo sasi e fertilizerëve të përdorur llogaritet që në bujqësi të jenë përdorur rreth 26592 ton Azot (N)[37].




Figura 30. Trendi i përdorimit të fertilizerëve 2004-2013 ton/vit[38]

Sektori i bujqësisë konsiderohet një nga sektorët që është burim i gazrave të serrës. Sipas të dhënave nga Inventari i gazrave serrë, në vitin 2012 ky sektor kontribuon me rreth 600 Gg CO_2 ekuivalent, që vijnë kryesisht nga përdorimi i uresë, fermentimi enterik nga bagëtitë, menaxhimi i plehut të stallës dhe menaxhimi i tokës bujqësore.

Sektori i bujqësisë si sektor kryesor i prodhimit të ushqimit ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e publik. Kualiteti i produkteve bujqësore, cilësia e tokave të përdorur për prodhimit e ushqimit në njërën anë si dhe ndikimi në ndotjen e ujërave sipërfaqësore nga produktet kimike që përdorën në bujqësi janë vetëm disa prej formave të ndikimit në shëndetin publik, ndonëse nuk ka të dhëna dhe hulumtime konkrete që do të vlerësonin këtë ndikim.

37 *Sasia e Azotit (N) është kalkuluar duke u bazuar në % e përmbajtjes së tij në kuadër të ferilizerëve të përdorur, (46% UREA, 32% NAG dhe 22% NPK).*

38 *Kalkulimi i të dhënave bazuar në Anketat e ekonomive shtëpiake bujqësore të ASK*




Figura 31: Trendi i emisioneve të CO_2 nga sektori i Bujqësisë

Me mbështetjen e Komisionit Evropian, gjatë vitit 2012-2014 është zbatuar projekti ALPS "Hulumtim për ndotjen e tokave bujqësore në Kosovë", i cili ndër të tjera ka pasur si objektivë të bëjë vlerësimin e gjendjes së tokave bujqësore në aspektin e kontaminimit dhe ndotjes. Në kuadër të projektit është bërë monitorimi i 214.749 ha të tokave bujqësore në 17 komuna. Janë marrë për analiza 2840 mostra të dheut[39]. (Për më shume shiko kapitullin për Tokën/dheun, në këtë raport).

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe zbutjes së ndikime mjedisore nga sektori i bujqësisë rekomandohet që të ngritjet një sistem i monitorimit të cilësisë së dheut, ku përveç tjera do të bëhej edhe monitorimi i cilësisë së dheut në toka bujqësore. Gjithashtu duhet të ndërmerren masa edhe në kuadër të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të pesticideve, ferilizerëve dhe produkteve tjera kimike që përdorën në bujqësi si dhe përhapjen e tyre në mediumet mjedisore. Finalizimi i inventarit te gazrave të serës nga ky sektor do të ndihmonte në identifikimin e të gjitha burimeve të gazrave të serrës nga bujqësia. Stimulimi dhe mbështetja e prodhimit të produkteve organike dhe mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërrimi i destinimit të tyre konsiderohet si nevojë që duhet zbatuar në të ardhmen.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Plani për bujqësi dhe zhvillim rural, 2010-2013, MBPZHR*	www.ask.rks-gov.net/bujqesia
• *Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2014, ASK*	www.mbpzhr-ks.net
• *Inventari i Pyjeve të Kosovës 2002 dhe 2012, APK*	www.fiskos.org
• *Raporti final i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore në Kosovë", GIZ 2015*	ww.alps-kosovo.org

39 *Raporti final i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore në Kosovë", GIZ International Services and NIRAS 2015*

3.5. Pylltaria

Pyjet janë ekosistemet më komplekse natyrore dhe kanë rendësi shumë të madhe ekologjike, ekonomike dhe shëndetësore. Ato janë rregullatorë natyror të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit dhe e mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpëlarja e shtresës produktive. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO_2 në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me oksigjen. Janë resurse natyrore të ripërtëritëshme, produktet e të cilave mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në te cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Ato përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe mjedise çlodhës për njeriun.

Sa i përket politikave nacionale për sektorin e pylltarisë, Kosova ka të miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, e përgatitur nga MBPZHR dhe e cila ka si objektiv të përgjithshëm që të rritet kontributi i sektorit pyjor në ekonominë nacionale, nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore, duke marrë parasysh rolin shumë funksional të pyjeve[40]. Dokument tjetër me rëndësi në sektorin e pylltarisë është dhe Strategjia e mbrojtjes së klimës në sektorin e pylltarisë e cila ka për qëllim identifikimin dhe analizën e institucioneve, politikave, mënyrave dhe formave për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serë dhe të largimeve të CO2 përmes akumulimit/reduktimit të tyre.[41] Ndërsa në kuadër të dokumenteve për mbrojtjen e pyjeve, është edhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020 e cila në kuadër të prioriteteve të saj (veprimeve strategjike) ndër të tjera parasheh që menaxhimi me pyjet të behët në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe skemave të certifikimit të pyjeve[42].

Sipas inventarit të pyjeve të realizuar në vitin 2013, pyjet dhe tokat pyjore përfshijnë 47.4 % e territorit të Kosovës ose 510200 ha, që shënon një rritje për 5% nëse krahasohet me regjistrimin e vitit 2002, ku pyjet përfshinin 44.7% të territorit të vendit ose 489000 ha. Pyjet e Kosovës janë të dominuar nga pyjet fletorë, duke mbuluar 93%. Pyjet halore mbulojnë rreth 5% të sipërfaqes pyjore (23 800 ha). Në total 180 800 ha (38%) e pyjeve të Kosovës është klasifikuar si pronë private, dhe 295 200 ha (62%) është klasifikuara si pyje publike. Vëllimi në këmbë i drurëve llogaritet në 40.5 milion m^3. Në mesin e drurëve, llojet *Fagus sp.* (Ahishtat) kontribuojnë me 46% të vëllimit, ndërsa llojet *Quercus sp*. (Dushqet) përfaqësojnë 23%. Mesatarja e vëllimit në këmbë të pyjeve në Kosovë është 84 m3/ha[43].

Rritja e numrit të popullsisë dhe zgjerimi i vendbanimeve kanë shtuar edhe nevojën për shfrytëzimin e burimeve primare të energjisë, ku bënë pjesë edhe biomasa pjesa më e madhe e së cilës vjen nga pyjet. Ndërsa nevoja për zhvillimin ekonomik ka shtuar edhe nevojën për shfrytëzimin e resurseve natyrore duke rritur kështu presionin në ekosistemet pyjore. Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon ndër të tjera në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore si: erozioni, ndryshimet klimatike, vërshimet etj.

40 *Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, MBPZHR*
41 *Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë, MBPZHR*
42 *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, MMPH*
43 *Inventari Nacional i Pyjeve në Kosovë 2012, APK*

Sipas analizave të kryera nga inventarizimi nacional i pyjeve të vitit 2012, mesatarja vjetore e prerjeve të masës drunore në pyjet e Kosovës është 1.6 milion m^3 nga të cilat rreth 1.0 milionë m^3 ndodhin në pyjet publike dhe 560 000 m^3 në pyjet private. Mbi 90% e prerjeve vjetore nuk janë kryer sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi, dhe këto parregullsi në 59 % të rasteve kanë ndodhur në pyjet publike dhe rreth 34% në pyje private. Vetëm një pjesë e vogël e prerjeve (7%) është kryer në përputhje me legjislacionin pyjor. Megjithëkëtë rritja vjetore e drunjve e cila vlerësohet të jetë rreth 1.56 milion m^3 është gati në balancë me prerjet vjetore (1.60 milion m^3). Studimi i inventarit të pyjeve vlerëson se bruto potenciali i prerjeve të qëndrueshme vjetore në Kosovë duhet të jetë rreth 1.45 milion m^3 me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë se rritjes vjetore[44].

Zjarret janë një faktor tjetër që ndikon jo vetëm në dëmtimin e pyjeve por edhe në rritjen e emisioneve të gazrave serrë nga ky sektor. Zakonisht zjarret në pyje krahas dëmtimit të vitalitetit të pyjeve shoqërohen edhe paraqitjen e sëmundjeve të tjera të pyjeve por edhe me humbje ekonomik. Sipas inventarit të pyjeve gjatë periudhës 2003 deri 2012 një sipërfaqe prej 12.200 ha, ose 2.5% e sipërfaqes totale pyjore është prekur seriozisht nga zjarret. Ndërsa sipas të dhënave të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, numri më i madh i sipërfaqeve të djegura të pyjeve ka ndodhur në vitin 2007 me rreth 10 mijë ha. Gjatë periudhës 2011-2013, janë djegur rreth 3500 ha (figura 32).




Figura 32: Sipërfaqet e djegura të pyjeve ha/vit 2003-2013[45]

Në kuadër të Inventarit Nacional te Gazrave të Serrës, sektori i pylltarisë, është një prej sektorëve më të rëndësishëm në reduktimin (akumulimin, thithjen) e emisioneve të CO_2 dhe konsiderohet si rezervuar i fuqishëm i karbonit atmosferik. Duke u bazuar në të dhënat inventarit të gazrave të serrës, në vitin 2012 nga kategoria Pyjet, janë akumuluar (reduktuar), rreth 40 mijë ton (40 Gg) CO_2 ekuivalent[46].

Në Kosovë, 0.5% për qind e pyjeve janë të rigjeneruara me pyllëzime ose farim natyral. Përafërsisht 85% e sipërfaqes pyjore është rigjeneruar me prejardhje

44 *Inventari Nacional i Pyjeve në Kosovë 2012, APK*
45 *Agjencioni i Pyjeve të Kosovës*
46 *Raporti nga Inventari i Gazrave Serrë për vitin 2012, AMMK*

vegjetative përmes cungjeve filizave/bisqeve. Ndërsa në kuadër të masave dhe aktiviteteve për zgjerimin e sipërfaqeve të pyllëzuara, gjatë periudhës 2005-2013 janë pyllëzuar rreth 3 mijë e 500 ha, sipërfaqe të zhveshura.




Figura 33: Sipërfaqet e pyllëzuara ha/vit 2005-2013[47]

Krahas ripyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura, hartimit të legjislacionit në sektorin e pyjeve dhe hartimit të dokumenteve tjera strategjike, si masa tjera me rëndësi që janë ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të gjendjes në sektorin e pyjeve duhet veçuar Inventarin e Pyjeve të Kosovës të realizuar në vitin 2013, dhe fillimin e procesit të certifikimit të pyjeve. Zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura të pyjeve të pastra përmes dy Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", mundë të konsiderohet si një veprim i rëndësishëm në mbrojtjen e këtyre ekosistemeve dhe llojeve që jetojnë në to.

Zbatimi i praktikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, ndalimi i prerjeve ilegale dhe rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve relevante, rekomandohet për përmirësimin e gjendjes në këtë sektor. Masa tjera që duhet zbatuar janë edhe parandalimi i zjarreve në pyje, zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura pyjore dhe hartimi i planeve menaxhuese për pyjet e larta.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, MBPZHR*	www.mbpzhr-ks.net
• *Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë, MBPZHR*	www.fiskos.org
• *Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2014, ASK*	www.mmph-rks.org
• *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, MMPH*	www.ammk-rks.net
	www.ask.rks-gov.net/bujqesia.

47 *Agjencioni i Pyjeve të Kosovës*

3.6. Turizmi

Turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një vendi. Por zhvillimi i tij ka ndikim negativ në mjedis e ne veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimit të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si jë formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm.

Kosova ende nuk ka strategji për zhvillimin e turizmit. Andaj akti kryesor ligjor që rregullon sektorin e turizmit është Ligji për Turizmin (Ligji Nr. 04/ L-176). Ky ligji ka për qëllim që të vendos parimet dhe rregullat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit si dhe vendosjen dhe zhvillimin e standardeve të shërbimeve turistike. Ndërsa që në parimet kryesore të ligjit janë edhe mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore[48].

Turizmi si degë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës, si rezultat i strukturave të dobëta organizative ka bërë që mos ta ketë shkallën e zhvillimit çfarë ofrojnë vlerat natyrore dhe kulturore të këtij vendi. Në Kosovë nuk ka ende një strategji të mirëfilltë për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit, dhe vetëm këto vitet e fundit ka filluar një organizim dhe marketing turistik më i dalluar. Megjithëkëtë ka rezultate në promovimin e vlerave turistike natyrore e kulturore të Kosovës në botë. Gjatë vitit 2013 forumi i kompanive lidere të turizmit "World Travel and Tourism Council", me seli në Londër, ka përzgjedhur Pejën, si qytetin më të bukur në rajon, duke u bazuar në potencialet turistike të Bjeshkëve të Nemuna duke fituar çmimin "Turizmi i së ardhmes" i themeluar më 1990 në Londër. Po ashtu në Maj të 2013 "Organizata Botërore e Turizmit" e ka vlerësuar Pejën dhe projektin ndërkufitar "Majat e Ballkanit", (i cili përfshin zonën ndërkufitare, Kosovë, Mali i Zi, Shqipëri) si destinacioni më i bukur turistik. Në listën e vendeve më të mrekullueshme të botës të shpallur nga MSN për vitin 2013, qyteti i Prizrenit gjendet në vendin e 9-të[49].

Në saje të këtyre promovimeve është rritur edhe numri i turistëve të jashtëm që vizitojnë Kosovën. Nëse e analizojmë numrin e turistëve të huaj në Kosovë dhe netët e qëndrimit që nga vitit 2008 e deri në vitin 2014, do të vërejmë se ka një rritje progresive edhe të numrit te turistëve por edhe të netëve të qëndrimit. Në vitin 2014, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës janë regjistruar rreth 61 mijë e 300 turistë të jashtëm me rreth 102 mijë netë qëndrimi, që shënon një rritje për rreth 10 mijë turistë dhe rreth 20 mijë natë qëndrimi më shumë (figura 34).

Rritje e numrit të turistëve dhe netëve të qëndrimit vërehet edhe sa i përket vizitorëve vendor. Krahasuar me vitin 2013, në vitin 20014 sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovë, janë regjistrua rreth 1000 turistë më shumë dhe po ashtu edhe rreth 800 netë qëndrimi më shumë (figura 35).

48 *Ligji për Turizmin (Ligji Nr. 04/ L-176)*
49 *Portali i Microsoftit, Dhjetor, 2013.*




Figura 34. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëve të qëndrimeve sipas viteve 2008 – 2014




*Figura 35. Numri i vizitorëve dhe netëve t*ë qëndrimeve sipas viteve 2008 – 2014

Në disa vende që dallohen për nga vlerat e rëndësishme të biodiversitetit dhe resurseve të tjera natyrore janë ndërtuar objekte për qëllime turistike që ndikojnë negativisht në ato mjedise si në florë, faunë, ekosisteme, peizazhe dhe në rrjedhat ujore. Ndërtimet e tilla të pa planifikuara dhe të pa kontrolluara ndikojnë dhe në ndryshimin e mikroklimës së atyre zonave, humbjes së vlerave natyrore dhe biodiversitetit etj. Një nga këta shembuj është rasti i Prevalles ku rrëzë rezervatit natyror përkatësisht zonës strikte të mbrojtur janë bërë ndërtime të pa kontrolluara me pasoja për bashkësinë bimore endemorelikte të rrobullit.

Resurse turistike kanë pothuajse të gjitha trevat e Kosovës, por "Malet e Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" janë zonat më të rëndësishme. Vlerat e paprekura të natyrës së Kosovës si dhe diversiteti i monumenteve kulturore-historike krijojnë mundësi të mira të zhvillimit turistik. Në tabelën vijuese janë prezantuar llojet e turizmit në Kosovë dhe niveli i zhvillimit të tyre.

Tabela 5: Potenciali turistik i Kosovës: Llojet, gjendja dhe mundësitë[50]

Llojet e turizmit	Përshkrimi	Gjendja		
		Aktual	Fillestar	Mundshëm
Natyrë	Grykat, majat e larta, parqet nacionale, monumentet e natyrës etj.		✓	
Burimet e ujërave	Banjat dhe burimet tjera të ujërave			✓
Shëndetësor	Parqet, banjat dhe zonat natyrore me efekt shëruese	✓		
Dimëror	Skijimi dhe format tjera të sporteve dimërore	✓		
Kulturor-Historik	Objektet kulturore, arkeologjike dhe historike si dhe ngjarjet kulturore		✓	
Rural	Destinacionet turistike rurale, ushqimet tradicionale dhe trashëgimia kulturore			✓
Gjueti dhe peshkatari	Zonat e gjuetisë dhe peshkatarisë			✓
Malor/Alpin	Zonat alpike malore, ecjet në natyrë, skijimi etj		✓	
Speleologjik (Shpella)	Shpellat dhe dukuritë speologjike			✓
Aventurë	Ngjitje, alpinizëm dhe sporte dimërore		✓	
Transit	Turizmi ditor, kalimtarë, ndërkufitare dhe regjional	✓		
Shkencor	Hulumtime shkencore, ekspedita hulumtuese, takime dhe ngjarje tjera shkencore			✓

Zhvillimi i sektorit të turizmit në Kosovë duhet të jetë i bazuar në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Oferta turistike në Kosovë duhet të jetë e bazuar në diversitetin e atraksioneve natyrore e kulturore dhe aktivitetet e ndryshme turistike të cilat nënkuptojnë mjedisin natyror dhe llojllojshmërinë e trashëgimisë historike e kulturore. Pra, sektori i turizmit në Kosovë duhet të jetë i qëndrueshëm dhe kualitativ dhe duhet të synojë të përmbushë dy qëllime: ngritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike të qytetarëve të Kosovës dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

50 *Divizioni i turizmit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, http://www.mti-ks.org/*

Strategjia kombëtare e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të promovoj zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e turizmit, që nënkupton zhvillimin që respekton principet e mbrojtjes së natyrës.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Statistikat e Hotelerisë 2015, ASK* • *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020, MMPH* • *Divizioni i turizmit i MTI*	www.mmph-rks.org *www.ask.rks-gov.net/*hoteleria *www.mti-ks.org*

4. Gjendja/S

Gjendja e mjedisit (State) përshkruan sasinë dhe cilësinë e fenomeneve fizike (psh. temperatura), fenomene biologjike (psh. rezervat e peshkut) dhe fenomenet kimike (psh. përqendrimi i CO2 në atmosferë) në një zonë të caktuar. Përmes treguesve të gjendjes mundë të përshkruhen për shembull pyjet dhe fondi i kafshëve të egra të pranishme në to, përqendrimin e fosforit dhe squfurit në liqene dhe lumenj, ose niveli i zhurmës në një lagje pranë një burimi të zhurmës sikurse janë aeroportet. Gjendja e mjedisit ndryshon për shkak të presioneve që i bëhen mjedisit. Ndryshimet e gjendjes se mjedisit ushtrojnë ndikime mbi përbërësit e mjedisit.

4.1. Ajri

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Me qëllim të mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Kosova ka hartuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit, e cila ka këto objektiva të përgjithshme: Të rriten mundësitë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në tërë Kosovën,

- Kompletimi i legjislacionit, në përputhje me Direktivat e BE-së, dhe të sigurohet korniza për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, në bashkëpunim me të gjithë komunitetet,
- Të sigurohet se cilësia e ajrit do të merret në konsideratë nga institucionet qeveritare, komunale, banorët, bizneset dhe organizatat, kur marrin vendime për veprimet e tyre dhe

- Të promovohet rëndësia e cilësisë së ajrit si përcaktues i shëndetit dhe mirëqenies së popullatës.

Në kuadër të monitorimit të cilësisë së ajrit është ngritur rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit i cili përbëhet nga 12 stacione automatike dhe një stacion mobil. Ky rrjet menaxhohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës që vepron në kuadër të AMMK-së.

Dy nga stacionet e vendosura në Prishtinë janë reprezentative për cilësinë e ajrit në sfondin **sub-urban** (IHMK) dhe në sfondin **urban-trafik** (Rilindja), po ashtu edhe stacioni i vendosur në Gjilan është reprezentativ për sfondin **urban–trafik** ndërsa 5 stacionet tjera të vendosura në Mitrovicë, Drenas, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, janë reprezentative për cilësinë e ajrit në sfondin **urban** dhe stacioni i vendosur në Brezovicë është për **sfondin rural**. Tri (3) stacione të **sfondit industrial** janë vendosura në zonën e KEK-ut (Dardhishtë, Palaj dhe Obiliq).

Përmes këtyre stacioneve monitorohen këta parametra: SO_2, NO_2, O_3, CO, PM10 dhe PM2.5. Në këtë raport të dhënat për këta parametra janë prezantuar për tri vite (2012-2014) për të gjitha stacionet që kanë qenë në funksion gjatë kësaj kohe.

Gjatë periudhës të cilës i referohet ky raport, në stacionet e vendosura në Prishtinë, Drenas dhe Mitrovicë për shkak të problemeve teknike në analizerët matës nuk ka të dhëna për parametrat SO_2, NO_2, CO, O_3 dhe PM10 dhe PM2.5, me përjashtim të stacionit i cili është i vendosur në Prishtinë (Rilindja) në të cilin janë bërë matje për PM10 dhe PM 2.5 nga viti 2014. Ndërsa stacionet e vendosura në zonën industriale të KEK-ut (Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj) janë instaluar nga fundi i dhjetorit të viti 2012 dhe të dhëna nga matjet në këto tri stacione ekzistojnë nga viti 2013.




Figura 36. Shpërndarja e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit

Në këtë raport është bërë vlerësimi vjetor i cilësisë së ajrit duke u bazuar në të dhënat nga rrjeti i stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit. Vlerat maksimale vjetore të lejuara për parametrat e cilësisë së ajrit janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 6: Vlerat kufitare vjetore për cilësi të ajrit[51]

Parametri	Përshkrimi i vlerat limite/mesatareve vjetore të lejuara	Vlerat kufitare vjetore
Materia Grimcore PM10	Numri i lejuar i ditëve të tejkaluara brenda vitit	35 ditë
	Vlera kufitare vjetore	40 $\mu g/m^3$
Materia Grimcore PM2.5	Vlera kufitare vjetore /Niveli për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	25 µg/m^3
Dyoksidi i Sulfurit (SO_2)-	Niveli për mbrojtjen e vegjetacionit/Mesatare vjetore	20 µg/m^3
Ozoni O_3	Niveli për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (mesatare ditore 8 orëshe, brenda vitit kalendarik)	>120 µg/m^3
	Niveli për mbrojtjen e materialeve	40 µg/m^3
Dyoksidi i Azotit (NO_2)	Vlera mesatare vjetore Niveli për mbrojtjen e shëndetit	40 µg/m^3
CO	Vlera kufitare ditore të mesatareve maksimale 8h (10mg/m^3)	Nuk parashihet

Vlerësimi i cilësisë së ajrit bazuar në të dhënat nga stacionet monitoruese- Siç vërehet nga figura 37 vlerat më të larta të SO_2, janë regjistruar në vitin 2014 dhe kryesisht në stacionet të cilat janë reprezentative për sfondin **industrial** dhe atë **urban-trafik**, por që tejkalime të vlerave ditore të lejuara (125 µg/m^3) brenda vitit 2014 nuk janë regjistruar në asnjë pikë të monitorimit. Po ashtu nuk janë regjistruar as tejkalime të vlerës vjetore të lejuar (20 ug/m^3) niveli për mbrojtjen e vegjetacionit.




Figura 37: Vlerat mesatare vjetore të SO_2

51 *Normativat e cilësisë se ajrit në Kosovë janë të rregulluara me Udhëzimin Administrative Nr.02/2011* për vlerat kufitare - *normat e cilësisë së ajrit*

Sikur vërehet nga figura 38 tejkalime të vlerave vjetore të lejuara të NO_2- niveli për mbrojtjen e shëndetit (40 ug/m^3), për periudhën e monitorimit 2012-2014 nuk janë regjistruar në asnjërin nga stacionet e monitorimit, por vlera më të larta në krahasim me stacione tjera janë regjistruar në stacionet Obiliq, Prizren, Gjilan dhe Hani i Elezit. Bazuar në pozicionin e këtyre stacioneve, mundë të konstatojmë se në ngritjen e përqendrimit të NO_2 përveç industrisë kontribuon edhe emisioni i gazrave nga automjetet (transporti) dhe emisionet nga lëndët djegëse që përdorën për ngrohjen e shtëpive.




Figura 38: Vlera mesatare vjetore e NO_2

Vlerësimi i përqendrimit të Ozonit ne ajrin ambiental është bërë duke krahasuar vlerat e regjistruara gjatë monitorimit dhe vlerat e dhëna për mesataren ditore 8 orësh, pragun e informimit dhe pragun e alarmit sipas kërkesave nga Direktiva 2008/50 dhe UA nr.02/2011. Nga të dhënat që janë prezantuara edhe në figurën 39 konstatojmë se gjatë vitit 2013 janë regjistruar tejkalime të vlerës mesatare ditor 8 orësh (120ug/m^3) dhe tejkalim të pragut të informimit (180 ug/m^3) në disa nga stacionet monitoruese. Ka raste kur vlera mesatare vjetore arrin deri në 97.7 ug/m^3 që lë të kuptohet se gjatë vitit ka pasur disa herë vlera mbi 120ug/m^3. Vlerat më të larta janë regjistruar gjatë vitit 2013 në stacionet Prizren, Hani i Elezit dhe Brezovicë.




Figura 39: Vlera mesatare vjetore e O_3

Nga vlerat mesatare vjetore të përqendrimit të CO të paraqitura në figurën 40 vërehet se vlera maksimale e mesatares vjetore është arritur në 2.5 mg/m^3 në stacionin e monitorimit në Peje, ndërsa në të gjitha stacionet tjera monitoruese janë regjistruar vlera shumë të ulëta, nga mundë të konstatojmë se gjatë periudhës monitoruese 2012-2014 nuk ka pasur tejkalim të vlerës limite kufitare ditore të mesatareve maksimale 8h (10mg/m^3) me CO në asnjë nga stacionet monitoruese.




Figura 40: Vlera mesatare vjetore e CO

Nga figura 41, vërehet se tejkalime të vlerës së lejuar vjetore të PM10 gjatë vitit 2012 janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura në Prizren, Gjilan dhe Han i Elezit, për vitin 2013 në stacionet Obiliq, Palaj, Dardhishtë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Han i Elezit, kurse për vitin 2014 në stacionet në Prishtinë (Rilindja), Obiliq, Palaj, Dardhishtë, Prizren dhe Gjilan. Pothuajse në të gjitha stacionet monitoruese janë konstatuar tejkalime të vlerave të lejuara vjetore me përjashtim te stacionit ne Brezovicë, reprezentativ për sfondin rural. Vlerat me të larta janë regjistruar në stacionet të cilat janë reprezentative për sfondin industrial dhe atë të sfondit urban-trafik, ndërsa vlera e ulët e paraqitur në stacionin e vendosur në Prishtine rezulton

edhe nga fakti se gjatë vitit ka pasur numër të vogël të matjeve.




Figura 41: Vlera mesatare vjetore e PM10

Vlerat mesatare vjetore për PM2.5, janë prezantuar në figurën 42. Për periudhën kohore 2012-2014, tejkalime të vlerave të lejuara vjetore gjatë vitit 2012 janë regjistruar në stacionet e vendosura në Prizren, për vitin 2013 në stacionet Obiliq, Palaj, Dardhishtë, Pejë, Prizren dhe Gjilan, kurse për vitin 2014 në stacionet në Dardhishtë, Prizren dhe Gjilan. Vërehet se tejkalime ka pasur pothuajse në të gjitha stacionet me përjashtim të stacioneve Prishtinë (Rilindja), Pejë (me përjashtim të vitit 2013) Hani i Elezit dhe Brezovica.




Figura 42: Vlera mesatare vjetore e PM2.5

Bazuar në analiza të burimeve të ndotjes si dhe në rezultatet e monitorimit mundë të konkludohet se si burime kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë konsiderohen Energjetika, Industria dhe komunikacioni.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe mbrojtjes së tij nga ndotja si dhe me qëllim që të përmirësohet monitorimit dhe raportimi për cilësinë e ajrit rekomandohet që:

- Të implementohet Strategjia dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e ajrit, si dhe të realizohen projekteve specifike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit,
- Të kompletohet inventari i emisioneve dhe burimeve të ndotësve në ajër,
- Të kompletohet dhe të funksionalizohet plotësisht sistemi nacional për monitorimit e cilësisë së ajrit me qëllim të përmirësimit të mbledhjes, përpunimin dhe raportimit të të dhënave për cilësinë e ajrit,
- Të forcohen kapacitetet teknike dhe institucionale për mirëmbajtjen e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, servisimin dhe kalibrimin e pajisjeve si dhe të bëhet akreditimi i laboratorëve.
- Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve monitoruese dhe operatorëve e sidomos në procesin e rrjedhjes së informatave, përpunimit, raportimit të tyre dhe informimit më efikas të publikut për kualitetin e ajrit.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ajrit 2012, AMMK*	*www.ammk-rks.net/ajri*
• *Cilësia e ajrit ne zonën e KEK 2013, AMMK*	*www.mzhe.rks-gov.net*
• *Strategjia dhe Plani i Veprimit për cilësinë e ajrit, MMPH*	*www.mmph-rks.org*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

4.2. Uji

Uji është resurs shumë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe për shëndet publik. Mirëpo trendet e zhvillimit të shoqërisë që po manifestohen me shtimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve prodhuese, bujqësia intensive, zgjerimi i vendbanimeve, urbanizimi dhe aktivitete tjera po ndikojnë jo vetëm në shfrytëzimin e këtij resursi por edhe në ndotjen e tij.

Edhe në Kosove, si në shumë vende të botës, shëndeti i njeriut dhe plotësimi i nevojave të tij është gjithnjë e më tepër i kërcënuar nga cilësia jo e mirë e ujit të pijes ose mungesa e ujërave të pastra. Mbrojtja, ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së resurseve ujore është njëra prej sfidave me të mëdha mjedisore para shoqërisë sonë. Zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve te lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurset tona ujore.

Me qëllim të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore gjatë vitit 2014, MMPH ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Ujërave e Kosovës 2015-2034, e cila është në procedurë për miratim. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është, menaxhimi efektiv i ujërave si një element qenësor i zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale të Republikës së Kosovës. Në pajtim me parimin e menaxhimit të integruar të ujërave, strategjia ka qasje të gjerë multisektorale që përpiqet të përfshijë të gjitha aspektet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave në Republikën e Kosovës, duke përfshirë përveç, tjerash edhe shërbimet më ujë të popullsisë dhe ekonomitë në zonat e banuara me: furnizimi më ujë, mbledhja e ujërave të zeza si dhe trajtimi i ujërave të zeza[52]. Me këtë strategji po ashtu janë definuar edhe objektivat strategjike për shfrytëzimin efiçent të ujërave, si dhe qeverisje të drejtë dhe efektive të ujërave.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon që në trupat ujorë të kemi rritje të vlerave në parametrat fizik, kimik dhe mikrobiologjik. Po ashtu, ndikime të shumëfishta vijnë edhe nga reshjet atmosferike: gazrat në ajër si (NO_x, SO_2, CO_2 etj) gjatë reshjeve atmosferike formojnë shirat acidik, që në mënyrë direkte ndikojnë në rritjen e aciditetit në ujëra. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri tek rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj) dhe atyre organike (PAH, PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujor janë edhe shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike- kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacione monitoruese). Treguesit që monitorohen janë

52 *Draft Strategjia Kombëtare për Ujërave e Kosovës 2015-2034*

10 parametra fizik (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Të dhëna të detajuara për të gjithë parametrat e monitoruar për të gjitha vendmostrimet e rrjetit të monitorimit të ujërave sipërfaqësore i gjeni në Raportin Gjendja e Ujërave në Kosovë 2015, të cilin e gjeni në ueb faqen e AMMK-së www.ammk-rks.net.

Në këtë raport gjendjen e ujërave e kemi pasqyruar përmes këtyre treguesve: Azotin e joneve Nitrate (N-NO_3), Fosforin nga jonet Fosfate (P-PO_4) dhe Oksigjenin Biokimik të Shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), për periudhe kohore nga viti 2008 deri në vitin 2014.

Ky vlerësim është bazuar në faktin se rritja e pranisë së Azotit të joneve Nitrate (N-NO_3), dhe Fosoforit nga jonet Fosfate (P-PO_4), shkakton eutrofikimin në ujëra, ndërsa që Oksigjeni Biokimik i Shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), tregon nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Në figurën 43 vërejmë se vlerat e azotit-N nga jonet Nitrate-N-NO_3 kanë luhatje nga viti në vit që kjo ndodh varshmërish nga sasia e fertilizerëve të përdorur brenda një viti kalendarik si dhe nga sasia e reshjeve, përbërja e ajrit dhe nga niveli i ndotjes në sipërfaqe të tokës. Vlerat e Azotit në përbërje të nitrateve për këtë periudhë kohore sillet në mes vlerave 0.66 dhe 1.18 mg/l.




Figura 43: Nitratet (mg N-NO_3^-/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2014); Në kllapa numri i stacioneve mostruese)

Treguesi tjetër i paraqitur, prezanton sasinë e joneve fosfate-PO_4^{3-} gjegjësisht sasia e fosforit në jonet fosfate P-PO_4. Nga analizat e bëra gjatë kësaj periudhe, sasia e fosforit në jonet fosfate P-PO_4 në ujërat e lumenjve tregon se presionet nuk paraqesin ndikim aq të shprehur tek ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të

paraqitura në diagram gjendet në mes 0.14 dhe 0.23 mg/l P-PO_4. Nga konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar nga eutrofikimi. (Figura 44).




Figura 44: Ortofosfatet (mg P-PO_4^{3-}/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2014); (Në kllapa numri i stacioneve mostruese)

Sipas rezultateve të prezantuara në figurën 45 Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit ($SHBO_5$), gjatë periudhës së monitorimit 2008-2014, nuk është i lartë. Vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 3.9 dhe 7.2 mg O_2/l , që tregon për ndotje jo alarmante por që ka një trend të rritjes në katër vitet e fundit. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, kjo ndotje mundë të arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore i ekspozohen gjithnjë ambientit të hapur ku ndotja nga mikroorganizmat e ndryshëm është e paevitueshme dhe ku pastaj shumimi i tyre është tejet i shpejtë.




Figura 45: Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit $SHBO_5$ (mg O_2/l), në ujërat sipërfaqësore 2008-2014; (Në kllapa numri i stacioneve mostruese)

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së ujërave, pas studimeve të fisibilitetit që janë përkrahur nga donatorët e ndryshime është planifikuar të fillojë ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotur për regjionin e Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Ferizajt dhe Mitrovicës. Studimi i fisibilitetit dhe projektit për Prizren, Gjakovë dhe Pejë është financuar nga KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) dhe Qeveria e Kosovës, ndërsa, studimi i fizibilitetit për trajtimin e ujërave urbane për Gjilanin, Ferizaj dhe Mitrovicë është financuar nga Bashkimi Evropian. Pritet që nga futja në funksion i këtyre impianteve të arrihen edhe rezultate në mbrojtjen e ujërave dhe përmirësimin e cilësisë së tyre.

Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Rrjeti hidrometrik përbëhet nga 22 stacione hidrometrike, disa prej të cilave nuk janë në funksion për shkak të problemeve teknike. Në këto stacione matën Niveli (h) dhe Prurja (Q). Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm), për disa stacione ku janë regjistruar matjen e nivelit për periudhën 2010-2014.

Tabela 7: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse[53]

STACIONI	LUMI	2010	2011	2012	2013	2014
Grykë	Bistrica Pejës	0.614	0.530	0.669	0.549	-
Drelë	Bistrica e Pejës	0.503	0.438	0.515	-	-
Prizren	Bistrica Prizrenit	0.463	0.361	0.589	0.666	0.593
Mlikë	Brod	0.763	0.579	0.638	0.668	0.588
Lluzhan	Llapi	1.141	0.843	0.699	0.860	1.042
Milloshëvë	Llapi	0.990	0.543	0.566	0.934	-
Viti	Morava Binçës	0.333	0.219	0.216	0.193	0.277
Hani Elezit	Lepenci	0.692	0.619	0.547	0.630	1.000
Brod	Lepenci	0.492	0.397	0.433	0.402	0.480
Gjakovë	Ereniku	0.690	0.519	0.597	0.743	0.583

Mungesa e monitorimit të ujërave nëntokësore është një nga problem qe kërkon zgjidhje. Vëmendje dhe rendësi te veçantë duhet ti kushtohet edhe ngritjes së infrastrukturës ujore, ngritjes së impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin ujërave, ndërkohë që kompletimi i legjislacionit në sektorin e ujërave dhe transpozimit të tij me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Ujëra, mbetet një nga prioritetet kyçe të sektorit.

53 *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ujërave 2015, AMMK*	*www.ammk-rks.net/raporte*
• *Kadastri i ndotësve te ujërave 2010, AMMK&REC*	*www.mmph-rks.org*
• *Strategjia Kombëtare për Ujërave e Kosovës 2015-2034*	*www.mmph-rks.org*
• *Disa fakte për mjedisin 2015, ASK*	*www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

4.3. Dheu/toka

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

Në kuadër të angazhimeve për mbrojtjen e tokës, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Konsolidimin e tokës 2010-2020 e cila si objektivë të përgjithshme ka realizimin e projekteve të konsolidimit të tokës dhe të sigurojë shfrytëzim racional të tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mbështetje për zhvillimin e bujqësisë.

Ndërsa në kuadër të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022 në kuadër të kapitullit për tokën si objektiva kryesore për këtë sektorë janë: hartimi i një strategjive të veçantë për menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës si burim natyror dhe parandalimi dhe zvogëlimi i degradimit të mëtejshëm të tokës nga ndotësit dhe erozioni.[54]

Sipas legjislacionit aktual në fuqi çështjet për mbrojtjen e tokës/dheut janë të adresuara përmes dy ministrive. Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja, erozioni, rregullimi, monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes dhe të gjitha ndryshimet në tokën bujqësore si vetitë fizike, kimike dhe biologjike janë përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.[55]

Ndërsa monitorimi i gjendjes së mjedisit dhe emisioneve në mjedis ku përfshihet edhe komponenta e dheut (tokës), është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjet tjera mjedisore.

Në Kosovë ende nuk ka sistem te monitorimit të tokës (dheut). Aktualisht as operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit nuk e bëjnë monitorimin e

54 *Stategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, MMPH*
55 *Ligji për token bujqësore (Ligji Nr. 02/L-26)*

rregullt të cilësisë së tokës (dheut), prandaj edhe AMMK ka mungesë të dhënave për kualitetin e dheut në këto zona.

Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm. Megjithkëtë ky problem është adresuar përmes projekteve specifike. Një nga këto projekte ka qenë projekti i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për studimin e tokës bujqësore në Kosovë (ALPS-Agriculure Land Pollution Survey). Përfitues kryesorë nga projekti kanë qenë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Projekti është implementuar nga organizata gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ dhe NIRAS nga Polonia. Qëllimi kryesorë i projektit ka qenë të bëjë vlerësimit e ndotjes së tokës bujqësore. Projekti gjithashtu ka pasur si objektivë edhe fuqizimin e legjislacionit dhe forcimi i kapaciteteve në stafin e MMPH, MBPZHR, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Institutit të Agrikulturës dhe Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinarisë për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së tokave bujqësore.

Në kuadër të projektit janë analizuar: 2840 mostra toke për 17 metale të renda, 2840 mostra toke për treguesit e pjellorisë, 200 mostra toke për përmbajtjen e ndotësve organik, 150 mostra bime për metale te renda dhe 100 mostra toke të konsideruara të dyshuara janë dërguar për ri –analiza.

Vlerësimi i ndotjes së tokës ka qenë i orientuar në zonat potenciale te ndotjes si: zonat industrial, uji i ndotur dhe mbetjet, përmbytjet, aktivitetet bujqësore etj.

Këto mostra janë marrë për analiza në 17 komuna të Kosovës dhe kanë përfshirë 4.101 km^2. Të dhënat më të detajuara për mostrat e analizuara sipas komunave dhe llojet e analizave janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 8: Llojet e mostrave të dheut të analizuara sipas komunave[56]

Komunat	Tokë bujqësore /ha	Mostra /ha	Mostra të analizuara për metale të renda	Mostra te analizuara për parametra të fertilitetit të tokës	Mostra e bimëve te analizuara për metalet e rënda	Mostra të analizuara për ndotësit organik në tokë
Drenas	12,550.00	50	249	249	15	7
Ferizaj	12,704.00	100	155	155	10	9
F.Kosovë	3,807.00	50	76	76	8	7
Gjilan	12,055.00	100	114	114	10	11
Leposaviq	20,800.00	50	242	242	10	12
Lipjan	12,910.00	50	260	260	7	12
Malishevë	16,069.24	100	157	157	8	7
Mitrovicë	14,954.00	50	166	166	10	10
Novobërd	4,207.00	100	50	50	6	5
Podujevë	18,827.00	100	208	208	7	8
Prishtinë	12,286.00	50	243	243	8	12
Prizren	15,429.70	100	148	148	8	10
Rahovec	13,662,94	100	158	158	8	10
Shtime	3,830.00	100	53	53	7	5
Suharekë	6,764.14	50	200	200	10	7
Vushtrri	12,263.00	50	283	283	10	8
Z. Potok	21,630.00	100	42	42	8	5
Total	**214,749**		**2804**	**2804**	**150**	**145**

Gjatë projektit janë arritur rezultatet në vlerësimin e detajuar në ndotjen e tokave bujqësore, identifikimin e burimeve, dhe janë dhënë rekomandimet për monitorimin dhe kontrollin e tokës bujqësore.

56 *Raporti final i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore në Kosovë", GIZ International Services and NIRAS 2015*

Rezultatet kyçe të projektit janë këto:

- Përqendrimet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cr, Ni, Cd, Pb, Hg, Zn, Cu, si dhe Ni) për 17 komunat janë brenda standardeve të ndotjes së tokës.

- Nivelet e larta të metaleve të renda (p.sh. të Cr, Ni, Pb dhe Cd), kanë rezultuar sipas studimit në terren që nuk kanë qenë zona bujqësore ose toka që përdoren për qëllime jo bujqësore/urbane.

- Nuk është identifikuar ndotja e të lashtave (perime, drithëra dhe fruta), nga metalet e rënda (në veçanti Cr, Ni, Pb, Zn,), prej mostrave të tokës për qëllime bujqësore në 17 komunave.

- Si pjesë e Sigurisë së Sistemit të Menaxhimit të Ushqimit, rekomandohet që të gjitha ushqimet bujqësore duhet të jenë rregullisht dhe sistematikisht të analizuar për të garantuar sigurinë publike dhe besimin[57].

Bazuar në rezultatet e projektit janë nxjerr rekomandimet për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore në të ardhmen:

- Të bëhet menaxhimi i mbeturinave sipas standardeve në tërë Kosovën, si dhe të fillojë ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për industrinë dhe ujërat urbane të përdorura;

- Të nxitet përdorimi i teknologjive më të mira në dispozicion (BAT) për menaxhimin e minierave dhe të ujërave të zeza, dhe për të kontrolluar ujë rrjedhat e deponive;

- Të monitorohen të ashtë quajturat "hotspotet mjedisore" dhe te aplikohet rehabilitimi i tyre.


- Të vazhdojë monitorimi i parametrave të cilësisë së tokës, pjellorisë së saj si dhe parametrat për cilësi të ushqimit,

- Të vazhdojë monitorimi i tokava edhe për 21 komunat tjera të cilat nuk janë përfshirë gjatë këtij projekti.

Një nga hulumtimet tjera që janë realizuar me qëllim të identifikimit të zonave potenciale të ndotura të tokave, ka qenë edhe hulumtim i realizuar nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në kuadër të së cilit janë identifikuar 28 zona me potencial të ndotjes[58]. Këto zona janë kryesisht të trashëguara si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës ose si rezultat i aktiviteteve minierave, nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide të skaduara etj. (Figura 46).

57 *Raporti final i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore në Kosovë", GIZ International Services and NIRAS 2015*

58 *Raporti, Hotspotet Mjedisore në Kosovë, AMMK 2011*



ID	Emri	Area_ha
01	Deponia minerare ne Kishnice	10.23
02	Deponia minerare ne Kishnice 2	2.85
03	Deponi minerare ne Artane	2.38
04	Deponi minerare ne Artane 2	3.94
05	Deponi sanitare e mbeturinave ne Podujeve	8.72
06	Deponi sanitare e mbeturinave ne Mitrovice	3.60
07	Deponia minerare e Kelmendit	23.78
08	Deponia minerare e Zveqanit	62.28
09	Depo me lende Radioaktive ne Mitrovice	0.03
10	Meterie Radioaktive PIM	0.04
11	Deponi sanitare e mbeturinave ne Peje	4.85
12	Kemikale te rrezikshme industriale ne Peje	0.12
13	Deponi sanitare e mbeturinave ne Prizren	20.94
14	Mbetje asbesti ne Han te Elezit	0.18
15	Rezervuar me Fenole ne Obiliq	177.64
16	Mbetje asbesti ne Han te Elezit 2	0.42
17	Mbetjet minerare ne Golesh	15.13
18	Deponi sanitare e mbeturinave ne Mirash	33.65
19	Deponia e hirit ne Obiliq	181.97
20	Deponi e hirit ne Obiliq 2	192.94
21	Deponia sanitare e mbeturinave ne Gjilan	20.50
22	Deponi e skories te Feronikelit ne Gllogoc	71.37
23	Deponia e flotacionit ne Deve te Gjakove	5.23
24	Mbetjet bujqesore ne Shiroke te Suhareke	0.04
25	Fabrika e shiritave te gomes ne Suhareke	17.17
26	Deponi minerare ne Leposaviq	20.31
27	Parku Industrial i Trepqes ne Mitrovice	115.10

Figura 46: Shpërndarja e zonave potenciale të ndotura

Një nga këto zona me potencial për ndotje konsiderohet edhe zona industriale e KEK-ut. Ky operator e bënë vetë monitorimin e gjendjes së tokave ne ambientet e TC-A dhe TC-B, me qëllim të përcaktimit të shkallës së ndotjes së tokës nga veprimtaria e Termocentraleve. Analizat bëhen për çdo muaj dhe mostrat analizohet në aspektin fiziko- kimike dhe përmbajtjes së metaleve të rënda (Hekur -Fe, Bakër- Cu, Plumb- Pb dhe Kadmium- Cd).[59] Sipas të dhënave nga raportet mujore të monitorimit të mjedisit në zonën e KEK, nuk ka tejkalime të parametrave që monitorohen.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti përfundimtarë i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore" GIZ&NIRAS, 2015* • *Raporti i hotspoteve mjedisore në Kosovë, AMMK 2013* • *Raporti, gjendja e mbeturinave dhe kemikateve në Kosovë 2014, AMMK*	www.ammk-rks.net/raporte www.mmph-rks.org www.esk.rks-gov.net

59 KEK; *Raporti i monitorimit mjedisor në TC Kosova A dhe TC Kosova, Janar, 2015*

4.4. Mbeturinat

Mbeturinat janë lëndë të cilat krijohen gjate aktiviteteve të përditshme. Zhvillimi i teknologjisë ka rezultuar me krijimin e llojeve të ndryshme të mallrave të paketuara dhe ambalazhuara dhe me materiale të ndryshme që pas shfrytëzimit të tyre, paketimi apo ambalazhi kalojnë në mbeturinë. Gjenerimi i mbeturinave komunale për koke banori ne Kosove është në rritje. Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare në Kosove viteve të fundit ka shënuar rënie të lehte. Gjendja e përgjithshme e deponive sanitare në Kosovë nuk është e mirë. Në Kosovë ende ka mbeturina të rrezikshme të trashëguara nga aktivitetet industriale dhe teknologjike.

Me qëllim të menaxhimit më efikas të mbeturinave, MMPH ka hartuar Strategjia për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022 e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i një kornize për të zvogëluar sasinë e mbeturinave dhe për ngritjen një sistemit të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave dhe zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;

Në mbështetje të Strategjisë është miratuar edhe Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 – 2017, i cili ka si qëllim kryesore menaxhimi e mbeturinave dhe mbrojtja e mjedisit përmes: forcimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, investimit në infrastrukturën për menaxhimin e mbeturinave dhe ngritjes së e shkallës së vetëdijes, ndërgjegjësimit dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave.

Edhe në nivelin Lokal, më shumë se 15 komuna të Kosovës kanë hartuar Plane Lokale për Menaxhimin e mbeturinave ndërkohë që 10-tëra të tjera janë në proces të hartimit të tyre.

Gjenerimi i mbeturinave për koke banori ne Kosove është në rritje. Prej vitit 2007 shihet një rritje konstante e gjenerimit te mbeturinave ndërsa ne vitin 2013 vërehet një rënie e lehte në gjenerim te mbeturinave për koke banori (Figura 47).




Figura 47: Gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori 2007-2013[60]

60 *ASK-Anketa e mbeturinave komunale 2007-2013*

Nëse i krahasojmë sasinë e mbeturinave të deponuara ne deponitë sanitare prej vitit 2007 e deri në vitin 2014 përsëri vërehet një rritje konstante ndër vite. Këtu përjashtim bëjnë vitet 2012 dhe 2014 ku sasie e mbeturinave te deponuara në deponitë sanitare në Kosove nga kompanitë për grumbullimin e mbeturinave është me e vogël (Figura 48). Gjendja në deponitë sanitare ne Kosove nuk është e mire ku në shumicën prej tyre kemi rrjedhje të ujërave të zeza nga deponia dhe kompaktimi i mbeturinave nuk behet sipas standardeve për administrimin e deponive.




Figura 48. Trendi i deponimit te mbeturinave ne deponitë sanitare ne Kosove 2007-2013

Sektori i mbeturinave konsiderohet një nga sektorët që është edhe burim i gazrave të serrës. Sipas të dhënave nga inventari i gazrave serrë, në vitin 2012 ky sektor kontribuon me rreth 380 ton CO_2 ekuivalent, që vijnë kryesisht nga gjenerimi dhe deponimi i mbeturinave dhe djegia e tyre. (Figura 49).




Figura 49: Trendi i emisioneve të CO_2 nga sektori i mbeturinave

Mbeturinat medicinale janë duke u trajtuar ne shtate impiante për sterilizim te mbeturinave medicinale të cilat gjenden ne regjionet kryesore të Kosovës. Sasia totale e mbeturinave medicinale të trajtuara nëpër këto qendra gjatë vitit 2014 është 417822.8 kg me një mesatare mujore prej 34526.8 kg. Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave është trajtuar ne impiantin e Prishtinës gjithsej 164739 kg ndërsa sasia me e vogël në impiantin e Gjakovës me 1779,9 kg. Impianti në Gjakove nuk është duke funksionuar gjatë gjithë kohës dhe si rezultat ka edhe sasinë më të vogël të mbeturinave të trajtuara.

Sipas anketimeve të bëra nga Agjencia e Statistikave te Kosovës sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara në Kosove ka pësuar rënie ne vitet e fundit. Përderisa në vitin 2010 në Kosove janë gjeneruar 580154 ton mbeturina në vitin 2013 pothuajse kemi përgjysmë me pak mbeturina industriale të prodhuara 302205 ton. (figura 50).




Figura 50: Gjenerimi i mbeturinave industriale 2010-2014[61]

Përkundër iniciativave dhe projekteve individuale në Kosovë ende nuk ka sistem të përgjithshëm për riciklimin e mbeturinave, ripërdorimin dhe trajtimin e tyre. Me qëllim të përmirësimit të sistemit për menaxhimin e mbeturinave rekomandohet që përveç implementimit të Strategjive dhe Planeve në sektorin e mbeturinave të punohet edhe më tutje në fuqizimin e institucioneve qendrore, lokale dhe kompanive për menaxhimin e mbeturinave, në hartimin dhe zbatimin i projekteve, planeve dhe programeve për riciklimit, trajtimit dhe ripërdorimin e mbeturinave dhe në ngritjen e vetëdijesimit.

61 *Anketa e mbeturinave industriale 2010-2013, ASK*

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti, gjendja e mbeturinave dhe kemikateve në Kosovë 2014, AMMK* • *Strategjia dhe për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022* • *Anketa e mbeturinave komunale 2007-2013, ASK* • *Anketa e mbeturinave industriale 2010-2013, ASK*	*www.ammk-rks.net/raporte* *www.mmph-rks.org* *www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

4.5. Biodiversiteti

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon apo në gjithë globin, ose shprehur ndryshe biodiversiteti paraqet llojllojshmërinë jetësore në tokë. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor.

Dokumenti më i rëndësishëm strategjikë për mbrojtjen e biodiversitetit të Kosovës është Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020. Ky përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe larmisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Republikës së Kosovës[62].

Dokumente tjera më rëndësi që e rregullojnë këtë fushë janë edhe: Strategjia e Pylltarisë 2010 – 2020, Strategjia e menaxhimit të kafshëve të egra dhe gjuetisë 2012-2022 dhe Strategjia e Produkteve Pyjore jo Drusore.

Gjendja e florës dhe vegjetacionit - Edhe pse janë bërë hulumtime të florës dhe vegjetacionit të Kosovës nga autor të ndryshëm vendor dhe nga shtetet e ndryshme të Evropës ende nuk është bërë një inventarizim i florës dhe nuk dihet numri i saktë i taksoneve bimore në Kosovë. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet së në Kosovë janë prezent afro 2.800-3.000 lloje të florës vaskulare.[63]

62 *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020*
63 *Libri i Kuq i flores vaskulare te Republikes të Kosovës, MMPH*



Lilium albanicum



Polygala doerfleri



Plantago gentianoides

Prerja e pyjeve pa kriter, degradimi i habitateve, ndryshimet klimatike globale janë faktor që po ndikojnë direkt që lloje të ndryshme bimore dhe shtazore të përballen me rrezik të zhdukjes. Habitate të rëndësishme janë duke u dëmtuar e degraduar dhe ekosistemet po destabilizohen si pasojë e ndërhyrjes së njeriut në veçanti në ekosistemet afër vendbanimeve. Në vitet e fundit si pasojë e prerjes së pyjeve pa kriter dhe përfshirjes nga zjarret e sipërfaqeve të mëdha të pyjeve, lloje të ndryshme rrezikohen të humbin habitatin e tyre dhe ardhjes në shprehje të llojeve invazive të cilat shpesh arrijnë të ndryshojnë strukturën floristike të ekosistemeve.[64]

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shekuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim është jo shumë racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të paparashikueshme. Dëme të mëdha po i shkaktohen bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale nga grumbullimi pa kriter i tyre.

Libri i Kuq i florës vaskulare - Me përkrahjen e GIZ-t gjerman dhe MMPH-se gjatë vitit 2013 është botuar Libri i Kuq i florës vaskulare të Kosovës. Me këtë është krijuar një pasqyrë reale për gjendjen e llojeve të rëndësishme të florës vaskulare të Kosovës, nivelin e rrezikshmërisë së tyre, faktorët dhe shkaqet kryesore që kanë ndikuar në rrezikshmërinë e tyre.

Lista e kuqe e florës vaskulare të Republikës së Kosovës është e rëndësishme sepse ajo e përqendron vëmendjen e të gjithëve që merren me natyrën në drejtim të rëndësisë që ka kërcënimi i biodiversitetit; ajo zbulon ato lloje të cilat kanë nevojë për masa mbrojtëse dhe vë bazat e informacionit për monitorim të mëtejshëm. Libri i kuq ka rëndësi të madhe sepse siguron informacionet të cilat ndihmojnë në përpilimin e prioriteteve mbrojtëse në nivelin lokal dhe mundëson një bashkëpunim më të mirëfilltë me organizata ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e mjedisit.

64 Po aty




Figura 51. Paraqitja grafike e numrit te llojeve bimore të cilat iu takojnë kategorive të ndryshme të kërcnueshmërisë

Ky vlerësim i pari i këtij lloji në Kosovë ka nxjerrë në përfundim se në territorin e vendit tonë në kuadër të llojeve të florës vaskulare: 61 lloje janë kategorizuar në shkallën të rrezikuara në mënyrë kritike (CR) , 86 lloje në kategorinë të rrezikuara (EN), 19 lloje në kategorinë të përkeqësuar (VU), 34 lloje në kategorinë gati të rrezikuara (NT) dhe 35 lloje në kategorinë më pak të rrezikuara (LC).

Gjendja e faunës - Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe të llojeve edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Hapësirat më të begatshme faunistike në Kosovë janë të gjitha masivet malore të Kosovës, por vlen të veçohen: Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.

Gjendja e përgjithshme e faunës është e përkeqësuar si pasojë e rritjes së pranisë njerëzore në vendbanimet e tyre dhe rrezikut të vazhdueshëm nga gjuetia ilegale që paraqitet kohë pas kohe, në veçanti gjatë vikendit në hapësirat e zonave të mbrojtura.



Lacerta viridis



Merops apiaster



Vulpes vulpes

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë dhe dhitë e egra, ndërsa zhvillim të mirë kanë ariu i murrmë dhe ujku. Rrezikun më të madh për zvogëlimin deri në zhdukje të rrëqebullit paraqet shfrytëzimi i gurit në rezervatin strikt të natyrës "Rusenica" i cili paraqet vendbanimin kryesor të këtij lloji të rrallë në PK "Sharri". Të rrezikuara janë gjithashtu edhe llojet e shpendëve grabitqar.

Llogaritet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksone të makrozoobentosit të ujërave. Numri i saktë i llojeve të faunës duhet të përcaktohet në bazë të inventarizimit që planifikohet të zbatohet në të ardhmen si gjatë hartimit të Librit të Kuq për faunën ashtu edhe në kuadër të projekteve tjera.

Me qëllim të mbrojtjes së biodiversitetit në Kosovë rekomandohet që: të bëhet hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe habitateve, të hartohet Lista e Kuqe e faunës së Kosovës, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore, mbrojtja e habitateve të llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsyesshmërive profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natura 2000.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti, Gjendja e natyrës 2011-2014, AMMK* • *Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020, MMPH* • *Libri i kuq i llojeve të florës vaskulare të Kosovës, MMPH 2014* • *Identifikimi paraprak i zonave të Natura 2000 në Kosove, PMQP 2009* • *Biodiversiteti i Kosovës, AMMK (www.ammk-rks.net/?page=1,23)*	*www.ammk-rks.net/raporte* *www.mmph-rks.org* *www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

4.6. Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Zonat e Mbrojtura të natyrës definohen si pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të veçantë me qëllim të ruajtjes të larmisë biologjike dhe peizazhore për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose për shkak interesit shkencor, kulturor, estetik, arsimor, ekonomik dhe interesave tjera publike. Me qëllim që këto vlera të natyrës të mbrohen, të konservohen dhe të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme tani më është e njohur dhe e dëshmuar praktika e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës.

Përveç Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2011-2013, si dokumente me rëndësi në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura janë edhe Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar Sharri dhe Planit Hapësinor për Ujëvarat e Mirushës, që janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës si dhe Plani i menaxhimit të PK Sharri i miratuar nga Ministri i MMPH-së. Gjatë vitit 2014-2015 është hartuar edhe drafti i Planit Hapësinorë për PK Bjeshkët e Nemuna, i cili tani është në procedurë të miratimit.

Aktualisht numri i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2014) është 116 dhe përfshijnë sipërfaqe prej 118.913,95 ha (10.9% e sipërfaqes të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate Strikte të Natyrës (Bifurkacioni i lumit Nerodime, Rezervati i Arnenit, Maja e Ropsit, Rusenica, Kamilja, etj), 2 Parqe Kombëtare (PK Sharri, PK Bjeshkët e Nemuna), 99 Monumente të Natyrës (Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit, Shpella e Gadimës, Ujëvarat e Mirushës, Gryka e Rugovës, Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë, Trungu i Rrapit në Marash etj), 1 Park Regjional i Natyrës (Gërmia), 2 peizazhe të Mbrojtura (Shkugëza dhe Pishat e Deçanit) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (Ligatina e Hencit-Radeves). Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtar: “Mali Sharr” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Tabela 9. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive

Kategoria IUCN	Emërtimi	Nr.	*Sipërfaqja /ha*	*Pjesëmarrja e ZM. %*
I	**Rezervatet Strikte të Natyrës**	**11**	**847**	**0.08**
	RN. Bimore	7		
	RN. Shtazore	2		
	RN. Hidrologjik	1		
	RN. Gjeologjikë	1		
II	Parqet Kombëtar	2	115957	10.6
III	Monumentet Natyre	99	5972	0.5
	MN. Spelologjike	9		
	MN. Hidrologjike	17		
	MN. Gjeomorfologjike	7		
	MN. Botanike	66		
V	Park Regjional i Natyrës	1	1126	0.1
V	Peizazh i Mbrojtur	2	85	0.007
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109	0.009
	Totali	**116**	**118913.95**[1]	**10. 90 %**[1]

Listën e plotë të zonave të mbrojtura dhe informata të detajuara për të gjitha zonat e mbrojtura i gjeni në Raportin për Gjendjen e Natyrës 2011-2014 te cilin mundë ta gjeni në ueb faqen e AMMK-së, www.ammk-rks.net

Gjatë vitit 2012 është shpallur edhe Parku i Dytë Kombëtarë i Kosovës, Parku Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" me sipërfaqe prej 62.488 mijë hektarë, dhe njëkohësisht është bërë zgjerimi i sipërfaqes së mbrojtur të Parkut Kombëtarë "Sharri" me rreth 20 mijë ha, duke rritur kështu sipërfaqen e mbrojtur nga 4.4 % në 10.9 % të territorit të Kosovës. Një kronologji e rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura në ha dhe pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në totalin e sipërfaqes së vendin që nga viti 1980 e deri në vitin 2014, është prezantuar në figurën 52.




Figura 52: Historiku i shpalljes së zonave të mbrojtura 1980-2014, sipërfaqja (ha) dhe pjesëmarrja e tyre (%) në totalin e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës




Figura 53: Zonat e mbrojtura sipas kategorive




Figura 54: Harta e zonave të mbrojtura

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe gjendjes së tyre rekomandohet që përveç hartimit të Planeve Hapësinore dhe atyre menaxhuese të punohet edhe në shenjëzimin dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura, themelimin e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura, harmonizimin dhe kategorizimi i zonave të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në realizimin e projekteve nacionale dhe ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti, Gjendja e Natyrës 2010-2014, AMMK* • *Identifikimi paraprak i zonave te Natura 2000 në Kosovë, PMQP 2009* • *Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës. MMPH-IKMN* • *Raportet për gjendjen e natyrës 2006-2007 dhe 2008-2009, AMMK* • *Studimi për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna, Park Kombëtar, IKMN 2003* • *Plani Hapësinor për PK "Sharri", AMMK/IPH*	*www.ammk-rks.net/raporte* *www.mmph-rks.org* *www.esk.rks-gov.net/mjedisi*

5. Ndikimet/I

Për shkak ndryshimit të gjendjes së mjedisit, paraqiten ndikimet (Impacts) të cilat kanë efekte në hallka të ndryshme të përbërësve të mjedisit sikurse janë ndikimet në ekosisteme, ndikimet në burimet natyrore dhe ndikimet në qeniet e gjalla. Pra ndikime në mjedis mundë të definohet të gjitha ata parametra që pasqyrojnë drejtpërdrejt ndryshimet në funksionet e përdorimit të mjedisit. Humbja e biodiversitetit dhe ndikimi në shëndetin e njeriut janë disa nga treguesit e ndikimit në mjedis.

5.1. Ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike padyshim se sot paraqesin një nga sfidat kryesore globale të njerëzimit në mbrojtjen e mjedisit. Me qëllim të zbutjes dhe adaptimit ndaj këtyre ndryshimeve, në nivelin global janë ndërmarrë veprime dhe janë arritur marrëveshje. Në vazhdën e këtyre janë edhe Deklarata e Rios (1992) me obligimet për zbatimin e konceptit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe Konventa për Ndryshimet Klimatike me obligimet për zvogëlimin e lirimit të gazrave me efektin serë në ajër. Edhe Protokoli Kyoto paraqet një hap shumë të rëndësishëm për kufizimin e emisioneve të CO_2, CH_4, N_2O, HFC_s – hidroflourokarburet dhe SF_6 – heksafloururi i sulfurit.

Derisa klima globale ka qenë shumë stabile gjatë 10 000 viteve të kaluara, duke siguruar një sfond për zhvillimin e qytetërimit njerëzor, tani ka shenja të dukshme se klima po ndryshon. Kjo është e njohur gjerësisht si një nga sfidat më të mëdha për njerëzimin. Matjet e përqendrimeve globale atmosferike të gazeve serë (GHG) tregojnë rritje të dukshme që nga koha para-industriale, me nivelet e dyoksidit të karbonit (CO_2), që tejkalojnë ndjeshëm nivelin natyror të së kaluarës prej 650 000 vjet. Përqendrimi i CO_2 atmosferik, nga niveli i kohës para-industriale është rritur për rreth 280 ppm, ndërsa në më shumë se 387 ppm në vitin 2008.

Në raport me politikat globale dhe evropiane për ndryshimet klimatike rrethanat me rëndësi të cilat duhet ti marrë parasysh Kosova janë se vendi ynë ende nuk është palë e Konventës Kornizë për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC), por Kosova synon anëtarësim në BE, që përfshin ndryshimin sipas legjislacionit të BE-së dhe zbatimin e tij dhe kështu në mënyrë graduale të kalojë nga statusi i vendit në zhvillim në atë të vendit të zhvilluar sipas Konventës UNFCCC. Duke qenë një shtet i ri, kapacitet dhe përvojat e saj në trajtimin e ndryshimeve klimatike janë shumë të kufizuara si pasojë e prioriteteve të tjera gjatë viteve të fundit.

Në kuadër të këtyre angazhimeve Kosova gjatë vitit 2014 ka hartuar Strategjinë për Ndryshime Klimatike e cila ka vendosur dy objektiva kryesore:

- Kosova do të zhvillojë kapacitete për t'i përmbushur obligimet e saj të ardhshme sipas Konventës UNFCCC dhe si anëtare e BE-së.

- Kosova do ta ngadalësojë rritjen e emetimeve të gazrave serrë përmes: rritjes së efiçiencës së energjisë në të gjithë sektorët, zhvillimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë, dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ndryshimet klimatike do të rritin ekspozimin në rreziqet nga thatësira, përmbytjet dhe zjarret në pyje. Prandaj fakte me rëndësi që duhet të merren për bazë kur flitet për ndryshimet Klimatike në Kosovë janë si vijon:

- Ndryshueshmëria e klimës tanimë është rritur në Kosovë, e kjo më së miri vërehet nga rritja e intensitetit dhe shpeshtësisë së reshjeve ekstreme siç janë shirat e dendur,
- Përmbytjet e menjëhershme po bëhen gjithnjë e më të rëndomta në viset malore, gjersa vërshimet e lumenjve po ndodhin gjithnjë e më shpesh në fusha dhe zona të ulëta;
- Kosova disa herë është goditur nga thatësira gjatë dy dekadave të fundit (1993, 2000, 2007, dhe 2008). Temperaturat e ngritura, reshjet e pakësuara dhe zvogëlimi i rrjedhave në kombinim me zhvillimet socio-ekonomike dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ujit do ta rrisin ekspozimin në thatësira;
- Që nga viti 2004, 80% e komunave të Kosovës janë përballur me mungesa të ujit për shkak të thatësirave hidrologjike dhe keqpërdorimit të burimeve të ujit[65].




Figura 55: Reshjet 1900-2014[66]

65 *Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024, MMPH 2015*

66 Të dhënat për reshjet 1900-2000 nga Banka Botërore (www.worldbank.org). Të dhënat 2001-2014 *nga IHMK*




Figura 56: Temperatura e ajrit 1900-2014[67]

Një nga shkaqet e ndryshimeve klimatike janë edhe rritjet në emisionet e GHG, që janë pasojë që vijnë kryesisht për shkak të përdorimit të lëndëve djegëse fosile, edhe pse shpyllëzimi, shfrytëzimi i tokës dhe bujqësia.

Sipas të dhënave nga Raporti për inventarin e gazrave serrë të vitit 2012 emetimet e gazrave serrë në Kosovë ishin gjithsej 9.5 Mt CO_2 equivalent (9526.74 ton). Sektori i Energjisë është kontribuuesi më i madhe i emisioneve të Gazrave të serrës me pjesëmarrje totale prej 87%. Në kuadër të sektorit të Energjisë, industria energjetike është dominante me 75% te emisioneve, kurse transporti rrugore kontribuon me 12% nga totali i emisioneve nga sektori i energjisë. Sektori i i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës përfaqëson 8% të totalit të emisioneve të gazrave serrë në nivel të vendit, sektori i mbeturinave me 4% kurse ai i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve është sektori më kontributin më të vogël me vetëm 1% të emisioneve totale. (Figura 57). Kategoritë kryesore të emisioneve të gazrave të serrës sipas IPCC, për vitin 2012 janë prezantuar në tabelën 10. Krahasuar me vitet paraprake, niveli i emetimit të emisioneve të GHG mbetet pothuajse i njëjtë.




Figura 57: Emisionet e Gazrave të Serrës (%) sipas sektorëve 2012

67 *Të dhënat për temperaturën 1900-2000 nga Banka Botërore (www.worldbank.org/country/kosovo).Të dhënat 2001-2014 nga IHMK*

Tabela 10: Kategoritë kryesore (kyçe) të emisioneve të gazrave të serrës sipas IPCC, për vitin 2012

Kodi i kategorisë së IPCC	Kategoria IPCC	Gazrat e serrës	2012 Ex,t (Gg CO_2 Eq)
1.A.1	Industria energjetike- karburantet e ngurta	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	6171.82
1.A.3.b	Transporti rrugor	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	996.94
3.A.1	Fermentimi enterik nga bagëtia	Metani (CH_4)	494.95
1.A.2	Përdorimi i karburanteve të lëngshme në industrinë prodhuese dhe atë të ndërtimit	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	365.43
1.A.4	Sektorët tjerë energjetike- karburantet e lëngshme	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	256.50
4.A	Deponimi i mbeturinave të ngurta	Metani (CH_4)	226.89
1.A.2	Përdorimi i karburanteve të ngurta në industrinë prodhuese dhe atë të ndërtimit	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	202.04
3.B.1.a	Tokat pyjore te mbetura toka pyjore	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	-39.21
2.A.1	Prodhimi i çimentos	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	83.99
1.A.4	Sektorët tjerë energjetikë – karburantet e ngurta	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	79.51
3.C.4	Emisionet direkt të N_2O nga menaxhimi i dheut/tokës	Oksidi i Azotit (N_2O)	78.99
3.C.5	Emisionet indirekte të N_2O nga menaxhimi i dheut/tokës	Oksidi i Azotit (N_2O)	75.19
3.C.3	Aplikimi i UREA-s në bujqësi	Dyoksidi i Karbonit (CO_2)	68.84
Totali i GHG për vitin 2012 nga të gjitha kategoritë			**9526.74**

Krahasuar me vendet tjera në Evropë, Kosova ka emetime më të ulëta për kokë banori (5.4 t CO_2 ekuivalent për kokë banori në vitin më 2012). Emetimet e gazrave serrë për kokë banori janë më të ulëta edhe se sa mesatarja e BE-së, ndërsa që janë pakë më të larta se mesatarja globale (figura 58).




Figura 58: Emetimet e CO2 (ton equaivalent) për kokë banori në Kosovë krahasuar me disa vende të regjionit, Evropës, EU, botë

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti, Inventari i Gazrave serre ne Kosovë per vitin 2012, AMMK* • *Emetimi i gazrave serre në Kosovë, 2008-2009, UNDP* • *Raporti per gjendjen e mjedisit, 2011-2012, AMMK* • *Strategjia për ndryshime klimatike 2014-2024, MMPH*	*www.ammk-rks.net* *www.mmph-rks.org* *www.ks.undp.org* *www.ecranetwork.org*

5.2. Shëndeti Publik

Shëndetin nuk përkufizohet vetëm si mungesa e sëmundjes, por edhe si mirëqenie e individit në dimension fizik, mendor, social dhe mjedisor. Gjendja e mjedisit në masë të konsiderueshme ka ndikim edhe në shëndetin e popullatës. Janë një sërë faktorësh mjedisor qe ndikojnë negativisht ne shëndetin publik si cilësia e ujit, cilësia e ajrit, menaxhimi i mbeturinave etj. Për shembull nga prodhimi i energjisë së bazuar në resurse fosile rritet ndikimi në mjedis dhe në shëndetin publik e sidomos në rritjen e numrit të të sëmurëve të organeve të frymëmarrjes, ndërsa që shumë sëmundje janë si rezultat i mungesës së ujit dhe sanitacionit. Ndërkohë që ekspozimi ndaj faktorëve të mjedisit që na rrethon sikurse janë ata biologjik (virueset, bakteriet etj), kimik (kompozimet organike dhe jo organike) dhe fizik (zhurma, rrezatimi etj), e faktorë të rrezikojnë shëndetin publik dhe sjellin sëmundje të ndryshme infektive, ngjitëse dhe kronike.

Është evidente se ndotja e mjedisit shkakton problem serioze ne shëndetin publik si: sëmundjet diarike, respiratore, te zemrës, te lëkurës, vdekje te parakohshme si dhe sëmundje te tjera. Nga figura 59 shihet se kemi një rritje konstante te sëmundjeve diarike ne Kosove nga viti 2002 deri ne vitin 2014. Ne këtë diagram nuk është përfshirë viti 2013 pasi që shumica e komunave gjatë këtij viti nuk kanë raportuar të dhënat e tyre.




Figura 59: Sëmundjet diarike ne Kosove 2002-2014[68]

Një nga treguesit e shëndetit publik është edhe jetëgjatësia në lindje. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, jetëgjatësia në lindje në Kosovë që nga viti 1999 e deri me 2013 ka pasur rritje. Që në mënyrë indirekte tregon për përmirësimin e kushteve të jetës dhe të mjedisit. Në vitin 2013 jetëgjatësia në lindje ishte 70 vite krahasuar me vitin 1999 kur ishte 67 vite (figura 60). Megjithkëtë krahasuar me vendet tjera të rajonit jetëgjatësia në Kosovë është më e ulët (Serbia 74.5, Mali i zi 74.6, Maqedonia 74.8, Shqipëria 76.9 dhe Kroacia 76.6).[69]




Figura 60. Jetëgjatësia në lindje[70]

Gjithashtu edhe numri i vdekjeve normale, mundë të përdoret si tregues për të prezantuar trendin e zhvillimeve në shëndetin publik. Në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave ky trend ka pasur oscilime gjatë periudhës kohore 2002-2013. Nga viti 2002 deri në 2006 vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të

68 *Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, 2015*
69 *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë për vitin 2012, UNDP*
70 Të dhënat nga Banka Botërore (www.worldbank.org/country/kosovo)

vdekjeve, pastaj në 2007-2008 një rënie e numrit të vdekjeve për të vazhduar prapë me rritjen e numrit të vdekjeve deri në vitin 2012, ndërsa që në vitin 2013 numri i vdekjeve shënon sërish rënie në krahasim me vitin paraprak. (Figura 61).




Figura 61: Numri i vdekjeve në Kosovë 2002-2013

Me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe mbrojtjes së shëndeti publik, një nga veprimet më të rëndësishme institucionale është përmirësimi i kushteve të sanitacionit. Së këndejmi në Kosovë që nga pas lufta e deri më sot janë bërë investime të vazhdueshme. Sipas raportit të performacës së Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit, në zonën e shërbimit të këtyre kompanive mbulushmëria me shërbimet e kanalizimit në vitin 2013 ishte 60% që shënon një rritje prej 10% më shumë se në vitin paraprak. (figura 62).




Figura 62: Mbulushmeria me shërbimin e kanalizimit (%), 2002-2012

Ndërsa mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit ishte 82%, që shënon një rritje prej 4% më shumë se sa në vitin paraprak. (figura 62)




Figura 63: Mbulushmeria me shërbimin e ujësjellësit (%), 2002-2012

Me qëllim të përmirësimit të shëndetit publik në përgjithësi por edhe vlerësimit të ndikimit të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik rekomandohet që të bëhen hulumtime më të detajuara për ndikimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në shëndetin publik. Po ashtu është e nevojshme të grumbullohen informacione dhe të dhëna të veçanta për numrin e sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve ambientale dhe të hartohen raporte të rregullta për kualitetin e ujit të pijes të cilat do të duhej të jenë në dispozicion të publikut. Është më se e nevojshme të investohet edhe më në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij, ndërsa që përdorimi i teknologjive të reja në energjetikë dhe industri si dhe favorizimi i përdorimit të burimeve të ripërtrishtme të energjisë do të ndikonte edhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit por edhe të shëndetit publik. Mbetet sfidë edhe rehabilitimi i zonave të ndotura.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Raporti për gjendjen e ajrit ne Kosove, AMMK 2013* • *Raporti për gjendjen e mjedisit, 2011-2012, AMMK* • *Raporti i përformacës së kompanive të ujësjellësve dhe kanalizimeve 2013, ZRRUK* • *Analiza mjedisore e shtetit (Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin) Banka Botërore* • *Statistikat e shëndetësisë 2013, ASK* • *Raporti i zhvillimit njerëzor 2010, UNDP* • *Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik*	*www.ammk-rks.net* *www.wwro.org* *www.ks.undp.org* *www.worldbank.org* *www.ask.rks-gov.net/shendetsia* *www.niph-kosova.org/*

6. Reagimet/Masat e ndërmarra

Reagimet (Responses) i referohen reagimeve nga grupe (ose individë) në shoqëri, si edhe nga Qeveria, veprime këto që kanë për qëllim parandalimin, kompensimin, përmirësimin ose përshtatjen me ndryshimet në gjendjen e mjedis. Disa nga reagimet e shoqërisë mund të konsiderohen edhe si forca shtytëse negative për faktin se synojnë të ndryshojnë trendet në procesin e konsumit dhe modelet e prodhimit. Të tjerat synojnë ngritjen e efikasitetit të produkteve dhe proceseve, përmes stimulimit, zhvillimit dhe përdorimit të teknologjive të pastra. Shembuj të treguesve të reagimit janë arritja e normave të riciklimit të mbeturinave komunale ose (sasia) shtimi i numrit të makinave me katalizator. Një tregues tjetër i shpeshtë që përdoret për të treguar reagimet ose përgjigjeje ndaj ndryshimeve të gjendjes së mjedisit është përshkrimi i investimeve mjedisore.

Reagimet (Responses) i referohen reagimeve nga grupe (ose individë) në shoqëri, si edhe nga Qeveria, veprime këto që kanë për qëllim parandalimin, kompensimin, përmirësimin ose përshtatjen me ndryshimet në gjendjen e mjedis. Disa nga reagimet e shoqërisë mund të konsiderohen edhe si forca shtytëse negative për faktin se synojnë të ndryshojnë trendët në procesin e konsumit dhe modelet e prodhimit. Të tjerat synojnë ngritjen e efikasitetit të produkteve dhe proceseve, përmes stimulimit, zhvillimit dhe përdorimit të teknologjive të pastra. Shembuj të treguesve të reagimit janë arritja e normave të riciklimit të mbeturinave komunale ose (sasia) shtimi i numrit të makinave me katalizator. Një tregues tjetër i shpeshtë që përdoret për të treguar reagimet ose përgjigjeje ndaj ndryshimeve të gjendjes së mjedisit është përshkrimi i investimeve mjedisore.

6.1. Legjislacioni

Hartimi i ligjeve në sektorin e mjedisit dhe në sektorë tjerë që ndërlidhen me çështje mjedisore, si dhe hartimi i akteve nënligjore dhe zbatimi i tyre është një prej masave kryesore që kanë ndërmarrë institucionet e Kosovës, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe parandalimin e ndotjes së tij përmes vendosjes së rregullave, standardeve, parimeve, procedurave dhe normave mjedisor . Shikuar nga ky aspekt Kosova ka një infrastrukturë të mirë të ligjeve mjedisore edhe pse zbatimi i tyre në praktikë kërkon angazhim më gjithëpërfshirës. Megjithkëtë Kosova nuk ka ligj specifik për Ndryshime Klimatike edhe pse kjo çështje deri diku është e rregulluar me ligje tjera sikurse është Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji i ajrit dhe ligjet tjera. Mungon po ashtu edhe Ligji për ekonfondin i cili do të ndihmonte në krijimin e një fondi të veçantë për mjedisin dhe realizimin e projekteve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Në tabelën vijuese janë prezantuar ligjet kryesore në sektorin e mjedisit dhe disa ligje tjera që rregullojnë çështje specifike që ndërlidhen me mjedisit.

Tabela 11: Korniza ligjore në sektorin e mjedisit

Ligji	Qëllimi i Ligjit
Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Nr. 03/L-025)	Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.
Ligji për mbeturina (Nr. 04/L-060)	Ky ligj ka për qëllim: evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.
Ligji për Ujërat e Kosovës (Nr.04/L-147)	Ky ligj ka për qëllim kryesorë të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës;
Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.04/L-174)	Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
Ligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave planifikimit hapësinor dhe ndërtimit (Nr.04/L-175)	Me këtë ligj rregullohen parimet, organizimi dhe mbikëqyrja inspektuese, koordinimi i mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedura për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.
Ligji për Kimikate (Nr.04/L-197)	Qëllimi i këtij ligji është menaxhimi i drejte i kimikateve te rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut te mundshëm nga kimikatet, te cilat mund te ndikojnë dhe shkaktojnë pasoja te renda për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin (Nr.03/L-153) e Ligjit për pyjet e Kosovës (Nr.2003/3)	Ky ligj i definon Pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
Ligji për veprimtaritë hidrometerologjike (Nr. 02/L-79)	Me këtë ligj rregullohen punët hidrometeorologjike dhe mënyra e kryerjes së tyre.

Ligji për shëndetësi publike (NR. 02/L-78)	E definon shëndetësia publike si disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale.
Ligji për veprimtaritë e ofertuesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit (Nr. 03/L-086)	Ky Ligj ka për qëllim të rregullojë punën e të gjithë ofruesve të shërbimeve në pronësi publike e shoqërore dhe furnizuesve të ujit dhe kanalizime dhe përcakton standardet e shërbimeve.
Ligji për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233)	Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë.
Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Nr. 04/L-086)	Ky Ligj e definon territorit e Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore.
Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri" (Nr. 04/L-087)	Ky ligj e definon territorin e maleve të Sharrit si tërësi hapësinore që veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me pyje të ruajtura, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe me vlera shkencore, kulturore, historike, peizazhore, sportive, rekreative – turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore.
Ligji për Gjuetinë (Nr. 02/L-53)	Qëllimi i ligjit është ruajtja e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtja adekuate e kafshëve të egra, sigurimi i mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të resurseve, nevoja për siguri dhe standardin e etikës së gjahtarëve.
Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Nr. 03/L-214)	Qëllimi i këtij ligji është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.
Ligji për vlerësim strategjik mjedisor (Nr. 03/L-015)	Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ligji për produktet biocide (Nr. 03/L-119)	Qëllimi kryesor i këtij projektligji është që të caktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdorën për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit.
Ligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve (Nr. 04/L-117)	Me këtë ligj rregullohet taksa rrugore për automjete të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe vendosja e taksës ekologjike për automjetet regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja. Taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së mjedisit.
Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-082)	Ne Kapitullin XXVIII gjegjësisht nga neni 347 deri 364 përfshin veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Krahas hartimit të legjislacionit mjedisor i është kushtuar kujdes i veçantë edhe përafrimit të legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane. Komisioni Evropian ka monitoruar progresin e harmonizimit të legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të BE-së dhe zbatimin e saj. Nëse e analizojmë aspektin e përgjithshëm të transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin nacional arrin shkallën rreth 60%, edhe pse disa nga direktivat mjedisore janë transpozuar 100%, (psh. Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë)por ka edhe të tjera që niveli i transpozimit është 0% (psh. Direktiva për ujërat larës). Në tabelën vijuese është prezantuar një përmbledhje e direktivave kryesore të BE-së për mjedisit dhe niveli i transpozimit të tyre në legjislacionin nacional mjedisorë.

Tabela 12: Transpozimi i legjislacionit nacional mjedisor me direktivat e Bashkimit Evropian

Fusha	Direktiva e BE	Niveli i transpozimit 2014[2]
Legjislatura horizontale	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	100%
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	100%
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	65%
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	100%
	Direktiva INSPIRE (2007/2/EC)	78%
	Direktiva për Krimin Mjedisor (2008/99/EC)	53%
	Direktiva për përgjegjësinë ndaj mjedisit (2004/35/EC)	84%

Kualiteti i Ajrit	Direktiva për kualitetin e ajrit ambiental (2008/50/EC)	91%
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër (2004/107/EC 4th Daughter Directive)	98%
	Direktiva NEC, Pragjet e emisioneve nacionale ne ajër (2001/81/EC NEC Directive	11%
	Direktiva për përmbajtjen e sulfurit të derivate te lëngshme (1999/32/EC Sulphur Cont. Liquid Fuels)	27%
	Direktiva për pikat e karburatëve VOC- Substancat Organike Volatine (94/63/EC VOCs Petrol)	98%
	Direktiva për fazën II për pikat e karburantëve VOC- Substancat Organike Volatine (2009/126/EU Stage II VOCs petrol)	30%
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva kornizë për mbeturina (2008/98/EC)	80%
	Direktiva për bateritë mbeturine (2006/66/EC)	40%
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	87%
	Diretkiva per PCB/PCT- Poliklorur Bifenili dhe Poliklorur Trifenili (96/59/EC PCB/PCT)	66%
	Direktiva për automjetet mbeturina (2000/53/EC End-of-Life Vehicles)	100%
	Direktiva për deponit (99/31/EC / Landfill)	100%
	Direktiva për kufizimin e përdorimit te disa substancave te rrezikshme ne pajisjet elektrike dhe elektronike (2011/65/EU RoHS)	50%
	Direktiva për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (2012/19/EU WEEE)	46%
	Direktiva për menaxhimin e mbetjeve minerare (2006/21/EC Mining Waste)	91%

Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	49%
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC) UWWT	44%
	Direktiva për ujërat nëntokësorë (2006/118/EC Groundwater)	36%
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	87%
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	25%
	Direktiva për ujërat larëse (2006/7/EC Bathing Water)	0%
	Direktiva për standardet e kualitetit të ujit (2008/105/EC)	4%
	Direktiva për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime (2007/60/EC Floods)	12%
	Direktiva për specifikacionin teknik për analiza kimike te monitorimit te statusit të ujërave (2009/90/EC Quality Assurance/Quality Control)	7%
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	100%
	Direktiva për habitatet (92/43/EC)	100%
	Direktiva për rregullat e mbajtjes së shtazëve të egra në kopshte zoologjike (1999/22/EC Zoos)	80%
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për emisionet industriale (2010/75/EU)	69%
	Direktiva Seveso III për Kontrollin e aksidenteve te mëdha industriale (2012/18/EU)	27%
	Direktiva për Kontrollin e materieve VOC (2004/42/EC -VOCs from Paints, Varnishes and Vehicle Refinishing Products)	25%
Kimikatet	Direktiva për klasifikimin, paketimit dhe etiketimin e substancave të rrezikshme (67/548/EEC CLP Directive)	65%
	Direktiva për Asbestin (87/217/EEC)	82%
	Direktiva për Biocide (98/8/EC)	84%
Zhurma	Direktiva për zhurmën mjedisore (2002/49/EC)	74%

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë* • *Kuvendi i Kosovës* • *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës* • *European Commission*	*www.mmph-rks.org* *www.kuvendikosoves.org* www.gzk-rks.net http://ec.europa.eu/environment/air/legis.htm

6.2. Strategjitë dhe planet mjedisore

Përveç masave ligjore, institucionet e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe sektorëve relevantë mjedisore dhe me qëllim të zbatimit më efikas të politikave afatgjate mjedisore kanë hartuar edhe Strategji , Plane dhe programe përkatëse. Në tabelën vijuese janë prezantuar Strategjitë, Planet dhe Programet nacionale për mjedis dhe për sektorë të caktuar mjedisor, për zona të mbrojtura dhe zona me rëndësi të veçantë, por edhe strategji dhe plane nacionale nga sektorët zhvillimorë që kanë ndikim direkt në mjedis ose që kanë për qëllim zbutjen e këtyre ndikimeve.

Tabela 13: Strategjitë, Planet dhe Programet në sektorin e mjedisit dhe sektorët që kanë ndikim në mjedis

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Institucioni përgjegjës për
Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisorë (Rishikimi dhe azhurnimi)	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2013-2017	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani i veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2017	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2014-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia Shtetërore e Ujërave	2015-202	Dokumenti është proceduar për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Programi i Monitorimit të Ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	2014-2015	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinore për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës”	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinorë për Zonën e mbrojtur me Interes të veçantë “Beteja e Koshares”	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-se, Kleçkë dhe Divjakë”	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë "Fusha e Mihjes së re"	2010-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Strategjia e Energjisë së Kosovës	2009-2018	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë	2013-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Plani Kombëtarë për Efiçencë të Energjisë	2013-2015	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës	2011-2018	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia Minerare e Kosovës	2012-2025	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë	2010-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Strategjia për Konsolidimin e tokës	2010-2020	Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Strategjia për Mbrojtjen e Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë	2013-2020	Draft nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Planin Nacionale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	2010-2013	Aprovuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprim	2012-2021	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Infrastrukturës

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë*	*www.mmph-rks.org*
• *Kuvendi i Kosovës*	*www.kuvendikosoves.org*
• *Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës*	www.kryeministri-ks.net

6.3. Monitorimi i mjedisit

Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit dhe mediumeve mjedisore, Kosova ka një sistem të monitorimit të mjedisit i cili përbëhet prej rrjeteve specifike monitoruese dhe prej formave tjera të monitorimit të bazuara në metodologji standarde, vëzhgim dhe vizita të rregullta monitoruese. Si rrjete të veçanta monitoruese janë rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit, rrjeti për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe rrjeti hidrometrik. Monitorimi i gazrave serrë është i bazuar në metodologji standarde, kurse monitorimi i zonave të mbrojtura apo ai deponive është i bazuar më shumë në vëzhgim dhe në vizita monitoruese. Të dhëna më të detajuara për sistemin aktual të monitorimit, llojet e monitorimit, frekuencën e monitorimit dhe parametrat (treguesit që monitorohen janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 14: Sistemi aktual i monitorimit të mjedisit në Kosovë

Lloji i monitorimit	Përbërja e rrjetit monitorues	Frekuenca e monitorimit	Parametrat/ treguesit qe monitorohen
Monitorimi i cilësisë së ajrit	12 stacione automatike dhe 1 stacion mobil	Matje kontinuale (24/7)	Dyoksidi i Sulfurit $SO_{2,}$ Monoksidi i Karbonit CO, Dyoksidi i Azotit $NO_{2,}$ Ozoni $O_{3,}$ Grimcat e Suspenduara PM10, Grimcat e Suspenduara PM 2.5.
Monitorimi i cilësisë së ujerave te lumenjve (ujerat sipërfaqësore)	54 vendmostrime ne 4 Pellgje lumore(23 Drini i Bardhë, 18 Ibri, 6 Morava e Binçës dhe 7 Lepenci)	18 stacione janë referente ku monitorimi bëhet 2 herë në vit, ndërsa në 36 stacionet tjera monitorimi bëhet në baza mujore	10 parametra fizik, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda.

Monitorimi i ujerave nëntokësore	Monitorim përmes projekteve dhe monitorimi nga disa KUR	Sipas projekteve dhe kërkesave	Parametrat kimik, parametrat fizik dhe metalet e rënda
Monitorimi i emisioneve dhe shkarkime ne ujera	Monitorimi sipas kërkesave nga inspektorati i mjedisit	Monitorimi sipas kërkesave nga inspektorati i mjedisit	Sipas qëllimit të kërkesës dhe sipas standardeve të aplikueshme
Monitorimi i sasisë se ujerave te lumenjve –rrjeti hidrometrik	22 stacione hidrometrike dhe 2 stacione për paralajmërim të rrezikut nga vërshimet	Tek stacionet hidrometrike niveli matet në mënyrë kontinuale (24/7) kurse prurjet 1-12 herë në vit, ndërsa tek stacionet për paralajmërim të rrezikut nga vërshimet matjet bëhen në kohë reale	Niveli (h), Prurja (Q) dhe profili i lumit
Monitorimi i gazrave serre	Përgatitja e inventarit te gazrave sere sipas sektorëve te IPCC	Përgatitja e inventarit ne baza vjetore	Gazrat e serrës (CO2,CH4, N2O, HFCs, PFCs, SF6.), nga keta sektorë: Energjia, Proceset Industriale dhe përdorimi i produkteve, Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimi i tokave dhe Mbeturinat
Monitorimi i dheut/tokës	Monitorimi përmes projekteve	Sipas projekteve dhe kërkesave	Prezenca e metaleve të rënda dhe e ndotësve organik në pikat e mostruara
Monitorimi i mbeturinave	Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes se deponive sanitare, regjionale, spitalore dhe deponive tjera	Vizita monitoruese paku dy herë në vit	Menaxhimi, kompaktimi, mbulimi i mbeturinave si dhe menaxhimi i ujerave në deponi dhe ndikimet ne mjedis.

Vete monitorimi nga operatoret ekonomik	Monitorimi nga KEK, NeëCo Feronikeli dhe Sharrcemi	Ditore, Mujore dhe periodike varësisht nga parametrat	Emisionet në ajër dhe ujë, shfrytëzimi i ujit, etj.
Monitorimi i zonave te mbrojtura	Monitorimi i rrjetit nacional të zonave te mbrojtura (105 zona të mbrojtura)	Se paku një here ne vit për secilën zonë monitorohet gjendja aktuale, ndërhyrjet ilegale, vlerat natyroret.	2 Parqe Kombëtare, 99 Monumente të natyrës, 2 Peizazhe te mbrojtura, 1 Park regjional dhe 1 zone e rëndësishme e zogjve
Monitorimi i biodiversitetit (llojeve të rralla te florës dhe faunës)	Monitorimi i llojeve të rrezikuara të faunës përmes kamerave kurth	Kamerat regjistrojnë lëvizjet e llojeve kafshëve dhe ato herë pas here kontrollohen për regjistrimet që kanë kapur ato	Rrëqebulli, dhia e egër, ariu i murrmë, pulegra etj.
Monitorimi i kushteve meteorologjike	5 stacione meteorologjike/ klimatologjike	5 stacione meteorologjike, Klmatologjike/ bejne maatje 3-6 here ne dite. Dy stacione meteorologjike/ matje ne kohe reale.	Temperatura e ajrit, shtypja e ajrit, lagështia, drejtimi dhe shpejtësia e erës, dukshmëria, insolacioni, reshjet, lartësia dhe tipet e reve, parashikimi i motit.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/AMMK*	*www.ammk-rks.net*
• *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë/MMPH*	*www.mmph-rks.org*

6.4. Investimet në mjedis

Investimi në mjedis është një prej formave direkte në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis. Qeveria e Kosovës, pjesën më të madhe të investimeve në mjedis e ka orientuar përmes buxhetit për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Por gjithashtu edhe komunat dhe institucionet tjera një pjesë të buxhetit e orientojnë në projekte mjedisore.

Duke analizuar buxhetin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për periudhën 2012-2015, vërejmë se ka pasur një rënie të vazhdueshme si për totalin e buxhetit ashtu edhe për investimet kapitale në mjedis. Derisa investimet kapitale në mjedis në vitin 2012 ishin mbi 60 milion euro, në vitin 2015 ato kanë rënë në rreth 35 milion euro (figura 64). Kjo deri diku mundë të arsyetohet me zvogëlimin e buxhetit të buxhetit për shpronësim që gjatë vitit 2012 ishte më i madh për shkak të shpronësimeve të pronave për projektin e autostradës si dhe me daljen nga kompetencat e MMPH-së të Agjencionit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Nukleare, dhe me themelimin e Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale e cila ka trashëguar edhe një pjesë të buxhetit për këto memoriale që menaxhohej nga MMPH.




Figura 64: Buxheti total i MMPH dhe buxheti i MMPH për shpenzime kapitale[71]

Sipas raportit Aktivitetet e donatorëve për periudhën 2012-2013, i hartuar nga Ministria e Integrimeve Evropiane, pjesa më e madhe e projekteve kapitale në sektorin e mjedisit janë mbështetur nga Buxheti Qendror i Kosovës me rreth 67% ose €103.730.00 euro, kurse komuniteti i donatorëve ka kontribuar me 33% ose me €50.292.397.

71 *Ministria e Financave www.mf.rks-gov.net*

Në vitin 2012, nga Buxheti Qendror i Kosovës janë financuar 72% e projekteve kapitale mjedisore ose €64,380,000, kurse komuniteti i donatorëve ka kontribuar me 28% ose €25,195,536, kurse për vitin 2013, nga buxheti qendror i Kosovës janë mbështetur 61% (€39,350,000) e projekteve mjedisore, dhe 39 % (€25,096,860) nga komuniteti i donatorëve (figura 65).




Figura 65: Investimet kapitale në sektorin e mjedisit nga Buxheti Qëndror i Kosovës dhe nga komuniteti i donatorëve për periudhën kohore 2012-2003[72]

Projektet e financuara nga Buxheti Qendror i Kosovës, kanë qenë të fokusuara në sektorin e Planifikimit Hapësinorë, Banimit dhe Ndërtimit me €59,765,000 në vitin 2012 dhe €39,350,000 në vitin 2013, kurse projektet e donatorëve kanë qenë të orientuara në sektorin e Mbrojtja e mjedisit dhe Sanitacioni i ujërave me €13,374,150 në vitin 2012 dhe €19,571,857 në vitin 2013.

Donatorët me të mëdhenj në këtë periudhë kohore kanë qenë Zyra e Komisionit Evropian me €10.7 milion (€5.6 milion në vitin 2012 dhe €5.2 milion në vitin 2013), Qeveria e Luksemburgut me €7.5 milion (€5 milion në vitin 2012 dhe 2.5 milion në vitin 2013), USAID me €3.6 milion ne vitin 2012, Qeveria Gjermane me €6.1 milion për vitin 2013.

Shikuar nga aspekti afatgjatë, një nga sektorët mjedisorë ku ka pasur investime më të mëdha në Kosovë është sektori i ujërave. Në sektorin e ujërave[73] janë bërë investime të rëndësishme si nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe nga donatoret e jashtëm. Investimet nga Qeveria e Kosovës kanë qenë të orientuar kryesisht në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe në përmirësimin e infrastrukturës ujore e sidomos në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Edhe investimet nga donatorët kanë qenë të orientuara kryesisht në përmirësimin e shërbimeve në sektorin e ujit dhe në studime të fisibilitetit për infrastrukturën për trajtimin e ujërave.

72 *Raporti për aktivitetet e donatorëve 2012-2013, MIE 2014,*
73 *Sektori i ujërave i referohet ujit të pijes, kanalizimit, ujitjes, akumulacioneve, lumenjve, administrimit të resurseve ujore, etj.*

Bazuar në të dhënat e disponueshme, që nga 1999, në sektorin e ujit janë investuar rreth 255.77 milion €, nga të cilat nga donatorët janë 189.9 € milion. Donatorët më të mëdhenj të huaj janë Bashkimi Evropian, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Gjermane përmes Bankës Zhvillimore Gjermane/KfW , të cilët së bashku kanë investuar 154.9 € milion, apo 61% nga totali i investimeve. Viti 2010, është viti që ka pasur më së shumti investime me gjithsej 26.63 milion euro. (Figura 66)




Figura 66: Investimet në sektorin e ujërave 2000-2012[74] (milion euro)

Përveç në sektorin e ujërave investimet e donatoreve kanë qenë te orientuara edhe në sektorë tjerë mjedisorë si në mbeturina, biodiversitet, vlerësimin e gjendjes së tokave, planifikim hapësinorë, ndryshime klimatike, ngritjen e kapaciteteve etj. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për disa nga projektet e rëndësishme të mbështetura nga donatorët.

Tabela 15: Disa nga projektet mjedisore të përkrahura nga donatoret për periudhën 2011-2015

Emri i projektit	**Donatori**	**Vlera e projektit në Euro**	**Koha e implementimit**
Faza e tretë e programit për mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)	SIDA- Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë	7.8 milion euro	2014-2015
Përkrahje në Menaxhimin e Ujërave dhe Monitorimin e Resurseve Ujore	Bashkimi Evropian (IPA)	1.2 milion euro	2012-2015
Përkrahje për Menaxhimin e mbeturinave	Bashkimi Evropian (IPA)	1.5 milion euro	2014-2016

74 *Trendi historik i investimeve në sektorin e ujrave në Kosovë, Msce. Arian Shuku 2012*

Studimi i ndotjes së tokës bujqësore në Kosovë (Mbështetje për MMPH dhe MBPZHR)	Bashkimi Evropian (IPA)	1.8 milion euro	2013-2015
Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt shoqërisë së shëndosh	JICA- Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë	5.1 milion euro	2011-2014
Projekti për pastrimin dhe rikultivimin e tokave nga ndikimi i sektorit të Energjisë	Banka Botërore	3.7 milion euro	2013-2015
Ngritja e kapaciteteve të MMPH në kompletimin dhe implementimin e legjislacionit në sektorin e mjedisit dhe planifikimit hapësinorë	Bashkimi Evropian (IPA)	1.8 milion euro	2011-2013
Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe konservimi i biodiversitetit në Dragash	UNDP-Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara	3.5 milion euro	2011-2014
Mbështetje për zhvillimet mbi emisionet e ulëta	ADC-Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe UNDP	0.5 milion euro	2013-2015
Iniciativa për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore	UNDP-Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara	0.8 milion euro	2013-2016

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë*	*www.mmph-rks.org*
• *Ministria e Financave*	*www.mf.rks-gov.net*
• *Ministria e Integrimit Evropian*	*www.mie-ks.net*

6.5. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në sektorin e mjedisit

Pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat rajonale mjedisore, në projekte dhe në organizata është një prej formave që mundëson jo vetëm rritjen e bashkëpunimit por edhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e mjedisit dhe në përmbushjen e obligimeve në procesin e integrimeve evropiane. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira nga këto aktivitete dhe zbatimi i tyre në Kosovë është po ashtu një mundësi që mundë të shfrytëzohet për avancimin e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimin e tij.

Në këtë raport janë prezantuar disa prej këtyre aktiviteteve, iniciativave dhe programeve në të cilat kanë marrë pjesë institucionet mjedisorë të Kosovës.

6.5.1. Kosova në Raportin: Mjedisi i Evropës-Gjendja dhe Perspektiva 2015

Në mars të këtij viti Agjencia e Mjedisit të Evropës Ka publikuar Raportin "Mjedisi i Evropës– gjendja dhe perspektivat 2015" i njohur ndryshe si SOER. SOER është dokument kyç i integruar për gjendje te mjedisit në Evropë, të cilin Agjencia e Mjedisit të Evropës e dorëzon te Parlamenti Evropian.

Raporti SOER 2015[75], përmban informata për mjedisin në Evropë,vlerësime për mjedisin në planin global, analizë krahasuese të shteteve përmes indikatorëve mjedisor dhe raporte specifike të shteteve dhe rajoneve. E gjithë kjo është bazë e mirë dhe mjet i çmueshëm në krijimin e politikave të ardhshme nacionale, evropiane për mjedisin.

Me rëndësi të posaçme për Kosovën, është se në pjesën 4, te SOER 2015, për herë të parë është hartuar kapitulli nacional për Republikën e Kosovës (Country briefing), në të cilin është dhënë vështrim i veçantë për gjendjen e mjedisit në shtetin tonë. Kapitulli nacional është në dispozicion për publikun e gjerë edhe ueb faqes së Agjencisë së Mjedisit të Evropës[76].

Republika e Kosovës, përmes Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës-AMMK si pjesë e rrjetit EIONET, aktivisht mori pjesë në tërë procesin e përgatitjes dhe hartimit të SOER-it 2015 krahas 38 vendeve tjera të Evropës.

Për me shumë detaje lexoni pjesën e Kosovës në Raportin Raportin "Mjedisi i Evropës– gjendja dhe perspektivat 2015" në linkun http://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo dhe shikoni sintezën e plotë të Raportin në linkun http://www.eea.europa.eu/soer#tab-synthesis-report .

75 http://www.eea.europa.eu/soer#tab-synthesis-report
76 http://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo

6.5.2. Pjesëmarrja në aktivitetet e EIONET dhe EEA

Kosova që nga viti 2010, në cilësinë e vendit bashkëpunues[77] është pjesë e EIONET - Rrjetin Evropian të Vëzhgimit dhe Informimit Mjedisor, me merr pjesë në aktivitetet që organizohen nga Agjencia e Mjedisit e Evropës/EEA. Pjesëmarrja e Kosovës, përkatësisht Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në aktivitetet e Agjencisë Evropiane të Mjedisit dhe në Rrjetin Evropian të Vëzhgimit dhe Informimit Mjedisor, EIONET është mundësuar në kuadër të projektit të IPA-s: "Pjesëmarrja e Vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën e EEA".

Projekti mes tjerash synon të përmirësojë procesin e rrjedhjes dhe shkëmbimit të dhënave në mes Agjencive të Mjedisit të vendeve të Ballkanit dhe Agjencisë së Mjedisit të Evropës, të përfshijë kontributin e tyre në kuadër të Vlerësimeve dhe Raporteve për gjendjen e mjedisit të Evropës, të mbështes Qendrat Kombëtare të Kontaktit dhe Qendrat Referentë Kombëtare në pjesëmarrjen e tyre në Punëtorit, Trajnimet dhe takimet e organizuar nga EEA dhe EIONET si dhe të ofrojë mbështetje tjetër teknike përmes ekspertëve dhe projekteve.

6.5.3. Pjesëmarrja në aktivitetet e EPA Network- Rrjeti i shefave te Agjencive Evropiane të Mjedisit

AMMK që nga viti 2011 është anëtare e rrjetit të shefave te Agjencive Evropiane të Mjedisit i njohur si EPA Network[78]. Gjatë kësaj kohe AMMK ka marrë pjesë aktive e të gjitha aktiviteteve të organizuara nga ky rrjet dhe për më tepër gjatë 2014-2015 ka qenë në treshen udhëheqëse të rrjetit ndërsa që në shtator të vitit 2014 ka qenë organizatore e takimit të 23-të me radhë të këtij rrjeti. Në kuadër të aktiviteteve ndër të tjera AMMK ka qenë iniciatorë e themelimit të rrjetit të Agjencive Mjedisore të vendeve të Ballkanit Perëndimorë dhe formimit të grupit të interesit për Ballkanin Perëndimorë në kuadër të rrjetit si dhe ka marrë pjesë aktive në hartimin e programit të punës për këtë grup.

Përndryshe, Rrjeti i Shefave i Agjencive Evropiane të Mjedisit i njohur si EPA Network, mbledh rreth vetës të gjithë udhëheqësit ose drejtorët e Agjencive Nacionale për Mbrojtjen e Mjedisit ose institucioneve të ngjashme të vendeve evropiane.

6.5.4. Pjesëmarrja e IHMK, në rrjetin e Sistemit Evropian të Vetëdijesimit për Përmbytje EFAS

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës-IHMK, në fillim të vitit 2015 ka marrë konfirmimin nga Instituti Suedez për Meteorologji dhe Hidrologji i cili përfaqëson qendrën Operative të Sistemit Evropian të Vetëdijesimit për Përmbytje, EFAS (European Flood Awareness System)[79], për pranim në këtë rrjet të organizatave.

77 https://www.eionet.europa.eu/countries
78 http://epanet.pbe.eea.europa.eu/european_epas/countries/kosovo
79 www.efas.eu

Paraprakisht Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Instituti Suedez për Meteorologji dhe Hidrologji kanë nënshkruar një dokument përmes së cilit përcaktohen kushtet e pjesëmarrjes në këtë organizatë. Zakonisht anëtarët e këtij rrjeti janë organizata dhe autoritete nacionale nga vendet e Evropës që kanë përgjegjësi për të ofruar shërbime dhe informata për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet. Me nënshkrimin e këtyre kushteve, IHMK si përfaqësues nacional i Kosovës për ofrimin e informatave nga sektori i hidrologjisë obligohet që të ofrojë informata dhe parashikime për përmbytjet në Kosovë edhe për Sistemin Evropian të Vetëdijesimit për Përmbytje, EFAS. Kjo pjesëmarrje do ti ofrojë IHMK-së, mundësinë e shkëmbimit të informatave dhe përfitimit të përvojave si dhe pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete tjera të organizuara nga EFAS.

6.5.5. Programi rajonal ECRAN

ECRAN (Environment and Climate Regional Accesion Network- Rrjeti regjional i Paraaderimit për Mjedis dhe Klimë), i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Komisioni Evropian, ndihmon përfituesit në shkëmbimin e informacionit dhe përvojës lidhur me përgatitjen për aderim. Ecran është forcimi i bashkëpunimit rajonal midis vendeve kandidate të BE-së dhe kandidate potenciale në fushën e mjedisit dhe veprimeve klimatike dhe ndihmon përparimin e tyre në transpozimin dhe zbatimin e acquis mjedisore dhe klimaterike të BE-së. ECRAN bazohet në përvojën e fituar dhe rezultatet e arritura nga RENA i (Rrjeti Rajonal Mjedisor për Anëtarësim) në veçanti ato që kanë të bëjnë me investimet mjedisore dhe klimaterike, transpozimin dhe zbatimin e ligjit të mjedisit dhe klimës, respektimit dhe zbatimit, iniciativave lokale dhe rajonale, veprim i klimës, ujit menaxhimit, menaxhimit të mbeturinave, cilësia e ajrit, shkarkimet industriale, mbrojtja e natyrës, VNM / VSM, përkrahje OJQ dhe pjesëmarrja e publikut. ECRAN përbehet nga tri komponenta kryesore: Mjedisi, Veprimi për klimën dhe Forumi OJQ-ve mjedisore. Aktivitetet nën secilin komponent zbatohen përmes një sistemi të Grupeve Punuese[80].

6.5.6. Parqet e Harkut Dinarik-Rrjeti rajonal i zonave te mbrojtura

WWF ka filluar projektin e Parqeve të Harkut Dinarik në fillim të vitit 2012, me qëllim për të krijuar një shoqatë të Parqeve Kombëtare dhe atyre Natyrore në territorin e vendeve përbërëse të Harkut Dinarik; Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi dhe Slloveni. Ky projekt tre-vjeçar është financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA.

Objektivi i parë dhe kryesor i këtij projekti ishte që të krijojë një rrjet të zonave të mbrojtura duke lidhur të gjitha parqet në rajonin e Harku Dinarik. Kosova është përfaqësuar në këtë projekt me dy Parqe Kombëtare: PK “Sharri” dhe PK “Bjeshkët e Nemuna” dhe me dy Parqe të Natyrës: Gërmia dhe Ujëvarat e Mirushës[81].

80 http://www.ecranetwork.org/
81 http://www.parksdinarides.org/en/kosovo

6.5.7. Projekti i zonës së pyjeve të ahut

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka filluar bashkëpunimin me Ministrinë Federale Gjermane për Mjedisin, Konservimin e Natyrës, Ndërtimin dhe Sigurinë Nukleare – BMUB dhe Agjencionin Federal Gjerman për Konservimin e Natyrës – BfN, si dhe Qendrën për Menaxhimin e Ekosistemeve – CEEM në Universitetin e Eberswaldit për Zhvillimin e Qëndrueshëm – HNEE, në lidhje me Projektin: "Pyjet e ahut – Trashëgimi Natyrore e Përbashkët e Evropës". Qëllimi i këtij bashkëpunimi është prezantimi i vlerave të pasura natyrore të vendit tonë, posaçërisht pjesa e vegjetacionit të pyjeve të vjetra të ahut që gjenden brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Bashkëpunimi në lidhje me këtë projekt ka filluar në vitin 2013 për të vazhduar me pjesëmarrje në punëtoritë dhe takimet e organizuara e parapara. Projekti do të vazhdoj deri në vitin 2017 dhe synimi kryesor është angazhimi i vazhdueshëm në mënyrë që zonat e lartpërmendura të marrin epërsinë e emërtimit dhe sa më shpejt që të jetë e mundur të diskutohet në nivelin kombëtar.

6.5.8. Zonat e Mbrojtura Ndërkufitare

Me qëllim të fuqizimit të mbrojtjes së natyrës në nivelin rajonal Kosova ka qenë pjesë aktive e disa iniciativave, projekteve dhe hulumtimeve në regjionin e Ballkanit Perëndimorë, apo edhe pjesë e iniciativave ndërkufitare me vendet fqinje Maqedoninë, Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e zi. Mbrojtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i zonave të mbrojtura, janë disa prej këtyre aktiviteteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve regjionale janë hartuar edhe dy studime për shpalljen e dy zonave të mbrojtura ndërkufitare:

Krijimi i Zonës së mbrojtur ndërkufitare "Bjeshkët e Nemuna" – Zona e propozuar për mbrojtje pritet të përfshijë Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë. Bjeshkët e Nemuna përfshijnë Malet dhe peizazhet unike dhe janë një nga rajonet më të rëndësishme për mbrojtjen e biodiversitetit në Ballkan dhe në gjithë Evropën. Ky rajon, konsiderohet të jetë ndër zonat malore me botë të egër ndër më ta rrallat jo vetëm në Gadishullin Ballkani por edhe në Evropë[82].

Krijimi i Ndërkufitare Sipërfaqe e mbrojtur "Sharr - Korabit - Deshatit" – Kjo zonë e mbrojtur është e është e vendosur në zonat kufitare të Shqipërisë, Kosovës dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe përfshinë peizazhe unike natyrore. Ky rajon trepalësh kufitar përfshin një numër të konsiderueshëm të habitateve natyrore dhe endemike dhe relikte të florës dhe faunës të rralla dhe të kërcënuara përfshirë specie të rëndësisë së përbashkët evropiane, si të ariut të murrmë dhe rrëqebullit të Ballkanit.[83]

82 http://www.unep.at/documents_unep/Balkan_Feasibility_Studies/Prokletije_25-10-2010.pdf
83 http://www.unep.at/documents_unep/Balkan_Feasibility_Studies/Sharr_25-10-2010.pdf

6.5.9. Programi i adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor

Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), është duke zhvilluar një program (2012-2015) me projekte të përbashkëta me institucionet Qeveritare të vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Kosovë) për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave[84].

Qëllimi kryesorë i këtij projekti është që institucionet nacionale të vendeve përfituese të cilat merren me monitorim të elementeve dhe dukurive meteorologjike dhe hidrologjike, të krijojnë kapacitete të mjaftueshme humane, teknike legjislative etj, në mënyrë që të jenë në gjendje që të monitorojnë duke siguruar informacione kualitative dhe të rregullta të këtyre proceseve, në mënyrë që të kenë mundësi për të parashikuar, prognozuar dhe paralajmëruar me kohë lidhur me motin, klimën, hidrologjinë etj.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është integrimi rajonal dhe ndërkombëtarë, duke synuar bashkëpunimin reciprok dhe shkëmbim të informacioneve, në mënyrë që institucionet relevante nacionale të kenë mundësi që të jenë operacionale.

6.5.10. Programi i ujit për Danubin (IAWD)[85]

Në vitin 2013 ka filluar së implementuari programi i ujit për Danubin me mbështetje të Bankës Botërore. Në kuadër të këtij programi merr pjesë edhe Kosova, krahas 12 shteteve të rajonit të Danubit, (Austria, Shqipëria, Ukraina, Rumania, Moldavia, Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi). Ky projekt ka për synim të ju ndihmoj këtyre vendeve në ndërtimin e shërbimeve të forta dhe të qëndrueshme të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujërave të zeza. Plani i Punës është strukturuar rreth pesë shtyllave vijuese: Politikat, Tarifat, Menaxhimi i pasurive dhe planifikimi i investimeve si dhe Përmirësimi i efikasitetit të shërbimit. Programi zbatohet duke përdorur tre instrumente kryesore: punë analitike dhe këshillimore, platformë për ndarjen e njohurive dhe aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve.

Referenca dhe burime shtesë:	***Burime në internet:***
• *Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/AMMK*	*www.ammk-rks.net*
• *Agjencia e Mjedisit e Evropës/EEA*	*www.eionet.europa.eu*
• *Rrjeti Evropian Mjedisor* për *Informim dhe Vëzhgim*/ EIONET	*www.eea.europa.eu*
• *Rrjeti EPA Network*	*www.epanet.pbe.eea.europa.eu*
• *Projekti ECRAN*	*www.ecranetwork.org*
• *Parqet e Harkut Dinarik*	*www.parksdinarides.org*

84 *Transboundary Water Management, Climate Change Adaptation in Western Balkan (www.giz.de)*
85 *http://www.danube-water-program.org/*

7. Referencat

1. *AMMK 2012, Raporti për gjendjen e ajrit*
2. *AMMK 2012, Raport Hotspotet Mjedisore në Kosovë*
3. *AMMK 2013, Cilësia e ajrit në zonën e KEK*
4. *AMMK 2013, Raport për gjendjen e mjedisit 2011-2012*
5. *AMMK 2014, Raporti, gjendja e mbeturinave dhe kemikateve në Kosovë*
6. *AMMK 2014, Raporti, Inventari i Gazrave Serre ne Kosovë për vitin 2012*
7. *AMMK 2015, Raporti për gjendjen e ujërave 2015*
8. *AMMK&REC 2011, Kadastri i ndotësve te ujërave 2010*
9. *AMMK/IKMN 2015, Raporti, Gjendja e natyrës 2010-2014*
10. *APK 2013, Inventari i Pyjeve të Kosovës 2012*
11. *ASK 2012, Regjistrimi i popullsisë 2011*
12. *ASK 2014, Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2014*
13. *ASK 2014, Anketa e fuqisë punëtore në Kosovë 2013*
14. *ASK 2014, Anketa e mbeturinave industriale 2013*
15. *ASK 2014, Anketa e mbeturinave komunale 2013*
16. *ASK 2014, Statistikat e shëndetësisë 2013*
17. *ASK 2014, Vlerësim-Popullsia 2013*
18. *ASK 2015, Disa fakte për mjedisin 2015*
19. *ASK 2015, Regjistrimi i Bujqësisë 2014*
20. *ASK 2015, Statistikat e Hotelerisë 2015*
21. *ASK 2015, Statistikat e mirëqenies sociale 2014*
22. *ASK 2015, Statistikat e transportit dhe telekomunikacionit 2015*
23. *EEA 2013, Environmental Indicators, Typology and Use in Reporting*
24. *EEA 2015, SOER 2015 — The European environment — state and outlook 2015, Countries and regions, Kosovo*

25. *EEA 2015, The European Environment-State and Outlok 2015*

26. *GIZ&NIRAS 2015, Raporti final i projektit "Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore në Kosovë"*

27. *Human Dynamics 2014, Monitoring transposition and implementation of the EU environmental acquis, Year 17 , Progress Report 9 , Kosovo*

28. *MBPZHR 2011, Plani për bujqësi dhe zhvillim rural, 2010-2013*

29. *MBPZHR 2011, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020*

30. *MBPZHR 2013, Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë*

31. *MI 2013, Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit 2012- 2021*

32. *MMPH 2012, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020,*

33. *MMPH 2012, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit 2011-2021*

34. *MMPH 2014, Libri i Kuq i florës vaskulare te Republikës të Kosovës, MMPH*

35. *MMPH 2014, Strategjia dhe për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022*

36. *MMPH 2014, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022*

37. *MMPH 2015, Strategjia Kombëtare për Ujërave e Kosovës 2015-2034*

38. *MMPH 2015, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024*

39. *Msce. Arian Shuku 2012, Trendi historik i investimeve në sektorin e ujërave në Kosovë*

40. *MZHE 2013, Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2013-2022*

41. *MZHE 2014, Balanca e Energjisë 2013*

42. *MIE 2014, Raporti për aktivitetet e donatorëve 2012-2013*

43. *PMQP 2009, Identifikimi paraprak i zonave të Natura 2000 në Kosovë*

44. *Raportet mujore dhe vjetore mjedisore të Departamentit të Mjedisit të KEK*

45. *Raporti vjetor 2013/2014, Departamenti i mjedisit, NewCoFeronikeli*

46. *UNDP 2010, Emetimi i gazrave serre në Kosovë 2008-2009*

47. *UNDP 2011, Raporti i zhvillimit njerëzor 2010*

48. *UNDP 2013, Raporti i zhvillimit njerëzor 2012*

49. *World Bank 2013, Analiza mjedisore e shtetit/Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin*

50. *ZRRUK 2014, Raporti i performances* së kompanive të ujësjellësve dhe kanalizimeve 2013

8. Indeksi i figurave dhe tabelave

8.1. Indeksi i figurave

Figura 1: Korniza analitike DPSIR

Figura 2: Numri i përgjithshëm i popullsisë dhe dendësia e saj 1948-2013

Figura 3: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 2002-2011

Figura 4: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006

Figura 5: % e popullsisë rurale dhe urbane në Kosovë 1948-2011

Figura 6: Sipërfaqet e vendbanimeve (ha) 2002-2012

Figura 7: Raporti në mes zonave të banuara dhe dendësisë se popullsisë në Kosovë dhe Evropë

Figura 8: Bruto Prodhimi Vendor-BVP për koke banori dhe Rritja e përgjithshme e BPV ne Kosove 2002-2013

Figura 9: Sasia e ujit të shpenzuar milion m^3/vit sipas sektorëve

Figura 10: Numri i operatoreve ekonomik qe kane aktivitet seperacionin e minerare

Figura 11: Shpërndarja hapësinore e operatoreve ekonomik që kanë aktivitet seperacionin minerar

Figura 12: Përdorimi i tokës (ha) sipas kategorive 2002 dhe 2012

Figura 13: Mbulushmeria e takova (%) sipas kategorive për vitin 2012

Figura 14: Harta e mbulushmërisë së tokave sipas metodologjisë Corine (CLC) në Kosovë për vitin 2012

Figura 15: Burimet primare të energjisë në dispozicion 2013

Figura 16: Konsumi i energjisë primare (ktoe) sipas llojit të lëndës djegëse (karburantit) 2003-2013

Figura 17: Raporti në mes të prodhimit total të energjisë elektrike dhe energjisë së renovueshme 2000-2013

Figura 18. Vlerat mesatare vjetore të pluhurit në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014

Figura 19. Vlerat mesatare vjetore të SO_2 *në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014*

Figura 20. Vlerat mesatare vjetore të NO_x *në TC A dhe TC B gjatë viteve 2007 – 2014*

Figura 21: Vlerat mesatare vjetore te emisioneve te pluhurit në furrat rrotulluese të NewCoFeronikeli 2013-2014

Figura 22: Vlerat mesatare vjetore te emisioneve te SO_2 dhe NO_x në furrat rrotulluese të NewCoFeronikeli 2013-2014

Figura 23: Vlerat mesatare vjetore e pluhurit në SharrCem gjatë viteve 2003 – 2014

Figura 24: Vlerat mesatare vjetore te SO_2 dhe NOx në SharrCem gjatë viteve 2003 – 2014

Figura 25: Rrugët e Kosovë 2010-2013

Figura 26: Numri i automjeteve në Kosovë 2006-2014

Figura 27: Trendi i shfrytëzimit të transportit hekurudhorë

Figura 28: Trendi i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari

Figura 29: Sipërfaqet e tokave bujqësore (ha) 2002-2012

Figura 30: Trendi i përdorimit të fertilizerëve 2004-2013 ton/vit

Figura 31: Trendi i emisioneve të CO_2 nga sektori i Bujqësisë

Figura 32: Sipërfaqet e djegura të pyjeve ha/vit 2003-2013

Figura 33: Sipërfaqet e pyllëzuara ha/vit 2005-2013

Figura 34: Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëve të qëndrimeve sipas viteve 2008 – 2014

Figura 35: Numri i vizitorëve dhe netëve të qëndrimeve sipas viteve 2008 – 2014

Figura 36: Shpërndarja e rrjetit për monitorimin e cilësisë se ajrit

Figura 37: Vlerat mesatare vjetore të SO_2

Figura 38: Vlera mesatare vjetore e NO_2

Figura 39: Vlera mesatare vjetore e O_3

Figura 40: Vlera mesatare vjetore e CO

Figura 41: Vlera mesatare vjetore e PM10

Figura 42: Vlera mesatare vjetore e PM2.5

Figura 43: Nitratet (mg $N\text{-}NO_3^-$/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2014);

Figura 44: Ortofosfatet (mg $P\text{-}PO_4^{3-}$/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2014);

Figura 45: Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit $SHBO_5$ (mg O_2/l), në ujërat sipërfaqësore 2008-2014;

Figura 46: Shpërndarja e zonave potenciale të ndotura

Figura 47: Gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori 2007-2013

Figura 48. Trendi i deponimit te mbeturinave ne deponitë sanitare ne Kosove 2007-2013

Figura 49: Trendi i emisioneve të CO_2 nga sektori i mbeturinave

Figura 50: Gjenerimi i mbeturinave industriale 2010-2014

Figura 51. Paraqitja grafike e numrit te llojeve bimore të cilat iu takojnë kategorive të ndryshme të kërcënueshmërisë

Figura 52: Historiku i shpalljes së zonave të mbrojtura 1980-2014, sipërfaqja (ha) dhe pjesëmarrja e tyre (%) në totalin e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës

Figura 53: Zonat e mbrojtura sipas kategorive

Figura 54: Harta e zonave të mbrojtura

Figura 55: Reshjet 1900-2014

Figura 56: Temperatura e ajrit 1900-2014

Figura 57: Emisionet e Gazrave të Serrës (%) sipas sektorëve

Figura 58: Emetimet e CO2 (ton ekuivalent) për kokë banori në Kosovë krahasuar me disa vende të regjionit, Evropës, EU, botë

Figura 59: Sëmundjet diarike ne Kosove 2002-2014

Figura 60. Jetëgjatësia në lindje

Figura 61: Numri i vdekjeve në Kosovë 2002-2013

Figura 62: Mbulushmëria me shërbimin e kanalizimit (%), 2002-2012

Figura 63: Mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit (%), 2002-2012

Figura 64: Buxheti total i MMPH dhe buxheti i MMPH për shpenzime kapitale

Figura 65: Investimet kapitale në sektorin e mjedisit nga Buxheti Qendror i Kosovës dhe nga komuniteti i donatorëve për periudhën kohore 2012-2013

Figura 66: Investimet në sektorin e ujërave 2000-2012 (milion euro)

8.2. Indeksi i tabelave

Tabela 1: Disa treguesit socio-ekonomik të popullsisë së Kosovës

Tabela 2: Sipërfaqet e degraduara sipas lumenjve

Tabela 3: Mesatarja e prerjes vjetore në pyje sipas llojeve të drurit dhe pronësisë (1000 m^3) sipas matjeve provë në 60% të territorit të Kosovës

Tabela 4: Të dhënat për cilësinë e ajrit në zonën e KEK sipas monitorimit nga IHMK

Tabela 5: Potenciali turistik i Kosovës: Llojet, gjendja dhe mundësitë

Tabela 6: Vlerat kufitare vjetore për cilësi të ajrit

Tabela 7: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse

Tabela 8: Llojet e mostrave të dheut të analizuara sipas komunave

Tabela 9. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive

Tabela 10: Kategoritë kryesore të emisioneve të gazrave të serrës sipas IPCC për vitin 2012

Tabela 11: Korniza ligjore në sektorin e mjedisit

Tabela 12: Transpozimi i legjislacionit nacional mjedisor me Direktivat e Bashkimit Evropian

Tabela 13: Strategjitë, Planet dhe Programet në sektorin e mjedisit dhe sektorët që kanë ndikim në mjedis

Tabela 14: Sistemi aktual i monitorimit të mjedisit në Kosovë

Tabela 15: Disa nga projektet mjedisore të përkrahura nga donatoret për periudhën 2011-2015

Raporti "Gjendja e Mjedisit në Kosovë, 2015"

është përgatitur nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Koordinatorë kryesor të përgatitjes së Raportit:

***Dr.sc. Ilir Morina**, Kryeshef ekzekutiv i AMMK*

***Rizah Hajdari**, Udhëheqës i DMVRM në AMMK dhe*

***Msc. Afrim Berisha**- Udhëheqës i Divizionit për Raportim, Plane dhe Programe në DMVRM*

***Kontribuuesit kryesor**ë:*

*Msc. **Afrim Berisha**, **Rizah Hajdari**, Dr.sc. **Sami Behrami**, Msc. **Taf Veselaj**, Msc.**Bajram Kafexholli**, **Sabit Restelica**, Dr.sc. **Mimoza Hyseni-Spahiu**, Msc. **Fadil Bajraktari**, **Letafete Latifi**, **Dr.sc. Ilir Morina**, Mr.sc. **Qenan Maxhuni**, Msc.**Merita Mehmeti**, **Vlora Spanca**, **Adriana Pllana**, **Ajet Mahmuti**, Msc.**Ndriçim Mustafa, Selvije Raci,** Msc. **Agron Shala** dhe **Shkumbin Shala***

Kontribuues tjerë:

Përparim Gashi, Hasan Hasani,** Dr.sc. **Bashkim Kastrati,** Msc. **Mentor Shala,** Mr.sc. **Nail Kryeziu, Filloreta Berisha** dhe **Andina Vllahiu

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Tel. +381 38 200 33 228 , email: kepa@rks-gov.net

www.ammk-rks.net

Prishtinë, 2015